


**Naim Frashëri**

# **KATER STINET**

BIBLIOTEKA

85H-32

F85



**albin**

81H-32

1185

Naim Frashëri  
KATER STINET

NAIM FRASHERI

---

# Katër stinët

Përktheu nga turqishtja  
Vexhi Buharaja



54686

Albinform  
1995

## „KATËR STINËT” \* DHE FILLIMET ROMANTIKE TË NAIMIT

### I

Veprat e para që shkroi dhe botoi Naimi në gjuhë të huaj, ndonëse për nga vlera dhe rol i që luajtën nuk hyjnë në krijimtarinë e tij madhore, prapë ato kanë rëndësinë e tyre jo vetëm si pikënisje në veprimtarinë letrare të poetit tonë, por dhe si krijime që i shërbejnë njohjes së atyre premiseve e faktorëve të cilat çuan në formimin ideo-artistik të Naimit, që njohim sot.

Dihet se Naimi është një prej përfaqësuesve më të shquar të romantizmit shqiptar dhe nga kjo pikëpamje ia vlen të dimë se cilat qenë interesat dhe ndikimet e hershme tek ai, nga ç’burime u ushqye në fillimet e veta letrare.

Është i njohur fakti se Naimi, në fillim, nuk u prezantua si poet romantik. Në hapat

---

\*) Novela „Katër stinët” gjendet në origjinal në Bibliotekën Kombëtare, me nr. skedari 154-V.20, M. Neim: Fusuli erbea — Istamboll 1300, turqisht, f. 127.

e para, ai u dha pas poezisë klasike persiane, u dashurua me veprat e Sadiut dhe Hafizit, shkroi qindra vjersha persisht dhe duke ndjekur traditën e letërsisë persiane, modellet e poetëve të preferuar, shkroi dhe botoi vëllimin poetik „Ëndërrimet” (Tehajjulât). Por më vonë, ai nuk ndoqi këtë rrugë dhe nuk kish si ta ndiqte. Fryma dhe mjetet tradicionale të poezisë klasike persiane dhe turko-arabe nuk i përgjigjeshin kërkesave të reja historike, nevojave të lëvizjes kombëtare që Naimi filloi me kohë t’i ndjejë e t’i kuptojë.

Në Zosimea ai kish mësuar gjuhën dhe letërsinë frënge, ish njohur me historinë e e Frangës, kish lexuar veprat e Rusoit dhe të Volterit. Naimi, pra, u ushqye me idetë e revolucionit borgjez dhe këto ide s’kish si të mos sillnin ndryshime në botëkuptimin e tij përgjithësisht dhe të koncepteve estetike në veçanti. Por këto ide me siguri do të kishin mbetur në kufijt e entuziazmit djaloshar edhe te Naimi, në qoftë se ai nuk do të ishte lidhur ngushtë me lëvizjen kombëtare të vendit të tij.

Hovi dhe organizimi që mori lëvizja jonë kombëtare pas ngjarjeve të Lidhjes së Prizrenit çelën para poetit tonë horizonte të pakufishme pune dhe lufte, i dhanë një përmbajtje konkrete botëkuptimit të tij.

S’ka dyshim që botëkuptimi i përparuar që përftuan idetë e revolucionit frëng te poeti ynë dhe militizmi nga ana e tij në lëvizjen kombëtare, qenë faktorët kryesorë që e bënë

Naimin të përqafojë një drejtim të shëndoshë letrar, siç ish romantizmi përparimtar.

Romantizmi në Evropë, në kohën kur e përqafoi Naimi, nuk ishte më në lulëzim, përkundrazi. Por dihet, për arsye historitke, se ai erdhi vonë në disa letërsi, siç ndodhi me letërsitë e vendeve të robëruara ose të prapambetura. Një fenomen i tillë ngjau edhe në letërsinë tonë dhe një aspekt të saj paraqet krijimtaria e Naimit.

Është e kuptueshme që Naimi, për kohën kur hyri në letërsi dhe për detyrat që kish para lëvizjes kombëtare, nuk mund të përqafonte klasicizmin, një drejtim letrar i kapërcyer i një shoqërie që po largohej nga skena e historisë, po as realizimin, që me parimet e veta kërkonte zbulimin e kontradiktave shoqërore dhe paraqitjen me vërtetësi të jetës. Në kushtet e shoqërisë së atëhershme shqiptare dhe të nivelit të letërsisë shqipe, romantizmi, ishte ndoshta i vetmi drejtim letrar që i përgjigjej nevojave imperative, për ta vënë letërsinë në shërbim të luftës çlirimtare.

Për këtë arsye na duket se paraqet mjaft intetres hulumtimi i atyre elementeve e premisave në krijimtarinë e Naimit që e pregatitën poetin tonë si romantik. Marrë nga kjo pikëpamje, novela „Katër stinët”, është një moment mjaft kuptim plotë.

Kalimi në pozitë e romantizmit përbën te një hap mjaft të rëndësishëm për Naimin po të kemi parasysh se ç'përfaqësonte perandoria mesjetare turke. Poeti ynë jetonte në një vend, ku ishin në fuqi obskurantizmi dhe

injanca, fanatizma e dhuna, ku jeta qe vënë nën zgjedhën e një sistemi feudalo-ush-tarak dhe feja e kleri kishin robëruar tërë sferat mendore e shpirtërore të njeriut. Nje-riu dhe jeta e tij shoqërore, bota e brendsh-me qenë krejt të huaja për letërsinë. Prandaj, ta drejtoje vëmendjen nga njeriu dhe shoqë-ria njerëzore, të çmoje botën e tij të bren-dshme, ndjenjat dhe mendimet, ta shikoje lumturinë e njeriut mbi tokë, të ngriheshe kundër asketizmit dhe të hymnizoje natyrën, ishte vetvetiu një reagim i hapur ndaj ideo-logjisë sunduese, ndaj letërsisë zyrtare dhe dogmave myslimane.

Përpjekjet e Naimit për ta bërë krijim-tarinë pasqyrë të jetës ishin pjesë e luftës së inteligjencies përparimtare në perandorinë turke kundër reaksionit feudalo-klerikal.

Ndryshimet ekonomike e shoqërore që ndodhën gjatë viteve të reformave të Tanzi-matit (1830-1870) sollën pasoja të rëndësish-me edhe në letërsi. Pikërisht nga kjo kohë, lind dhe zhvillohet letërsia borgjeze turke. Shkrimtarët e brezit të ri si Shinasiu, Zija Pasha, Ahmet Mitati etj. luftuan me ithtarët e kulturës feudale dhe epigonët e poezisë klerikale, zhvilluan një veprimtari të gjerë iluministe. Në kundërshtim me letërsinë e mëparshme, këta i vunë vetes për detyrë ta lidhin letërsinë me jetën reale, t'i kushtojnë vëmendje njeriut dhe problemeve të rëndë-sishme që shqetësonin kohën e tyre. Këto përpjekje gjetën pasqyrim jo vetëm në bren-dinë e re që filloi të rrjedhë në letërsinë tur-

ke, po dhe në format e reja letrare që u lavruan si novela, romani, drama, të panjohura deri atëhere prej letërsisë zyrtare.

Në radhët e para të kësaj lufte që bënte intelegencia turke do të qëndronte dhe Samiu, i njohur me emrin Shemsedin Sami. Në këtë luftë, me sa duket, u angazhua dhe Naimi. Por angazhimi i Naimit në terrenin turk nuk vazhdoi gjatë. Ndryshe nga Samiu, që forcat kryesore krijuese i lidhi me luftën e inteligencies turke për progresin shoqëror e politik në vendin ku jetonte, Naimi talentin dhe tërë aftësitë e veta, duke filluar nga mezi i viteve 80 ia kushton kryesisht kauzës së çlirimit të atdheut. Në fakt, novela „Katër Stinët”, është e vetmja vepër letrare turqisht që përbën kontributin e Naimit në luftën e përbashkët për progres.

Dihet se Samiu zhvilloi një punë të madhe me karakter iluminist, jo vetëm duke përkthyer libra si „Historia e Francës” apo duke dhënë në turqisht një sërë veprash letrare të huaja, ndërmjet të cilëve dhe „Të mjerët” e V. Hugoit, po dhe duke themeluar e drejtuar organe të ndryshme e duke marrë niasiativa të tjera që i shërbenin zgjimit dhe emancipimit të popullit.

Në këtë drejtim një rëndësi të madhe ka themelimi prej tij i **Bibliotekës së xhepit**, më 1884. Në këtë punë, Samiu, duke marrë mbi vete barrën kryesore, tërhoqi botuesin më të shquar të Stambollit, armenin Mihran. Naimi, që sapo ishte vendosur aso kohe përfundimisht në Stamboll, i erdhi, me sa duket, në



ndihmë të vëllait.

Në serinë e Bibliotekës së xhepit u botuan vepra me karakter divulgativ që përhapnin njohuri shkencore mbi njeriun, shoqërinë dhe botën, pikëpamje të drejta mbi moralin, mbi gruan etj. Naimi përgatiti për Bibliotekën e xhepit dy vepra: „Zbulime dhe shpikje”, një libër i vogël me karakter shkencor divulgativ dhe „Katër stinët”.

Novela „Katër stinët” ishte kryesisht veprë për letrare, fare e ndryshme nga shoqet e saj të serisë. Por megjithëse kemi të bëjmë me një veprë letrare, „Katër stinët”, siç do ta argumentojmë më poshtë, në thelb përkonte me qëllimin e përgjithshëm që kish Biblioteka e xhepit: t'i shërbente përhapjes së ideve e koncepteve të reja mbi jetën shoqërore e shpirtërore të njeriut, t'i vinte në ndihmë emancipimit të shoqërisë, të luftonte fanatizmin dhe dogmat e ngurta të fesë myslimane.

Novela „Katër stinët” u botua më 1884 në Stamboll, në shtypshkronjën e Mihranit nën titullin turqisht „Fusuli erbea”. Në frontespic lexojmë: Biblioteka e xhepit Nr. 16, „Katër stinët — Marrë nga frangjishtja prej M. Neim. Botuar me lejën e Ministrisë së Arësimit, Instanbol Shtypshkronja e Mihranit, Rr. Porta e Lartë, Nr. 7, 1300 (1884).

Problemi i parë që del përpara sigurisht ka të bëjë me shkallën e origjinalitetit të veprës. Vetë shënimi që thotë se është marrë nga frëngjishtja, tregon qartë se nuk jemi para një veprë krejtësisht origjinale. Por mungesa e emrit të autorit dhe hulumtimet që kemi

bërë në veprat e shkrimtarëve romantikë të preferuar të Naimit, siç qenë V. Hugoi dhe Lamartini, na nxisin të pohojmë se nuk kemi të bëjmë as edhe thjesht me një përkthim. Na e thotë mendja se lënja jashtë e emrit të autorit s'është pa arsye. Në qoftë se Naimi do ta kish përkthyer këtë vepër, duke i qëndruar hesnik orgjinalit, logjika e do që ai ta vinte emrin e autorit, ashtu siç do të ndodhte më vonë me përkthimin e këngës së parë të Iliadës së Homerit.

Ne mendojmë, siç do të përpiqemi të arësyetojmë më tutje, se „Katër stinët” s'është as vepër krejtësisht origjinale, as thjesht përkthim, po një përshtatje e lirë. Ka shumë mundësi që Naimi ta ketë marrë nga ndonjë vepër e letërsisë frenge, idetë, subjektin, personazhet dhe elemente të tjerë dhe këto t'i ketë përpunuar lirisht, duke futur dhe një pjese elementesh të veta. Një praktikë e tillë ishte e njohur në letërsinë turke të asaj kohe. Nga mungesa e traditës, sidomos në fushën e prozës, kish autorë që subjektet, motivet, figurat apo dhe elemente të tjerë i merrnin nga letërsia perëndimore, veçanërisht nga ajo franceze dhe i trajtonin pastaj në mënyrën e tyre, simbas mundësive dhe aftësive të veta.

Dihet se vjersha e njohur e Naimit „Të varfërit” ishte një përshtatje e një vjershe homonime të V. Hugoit, po që poeti ynë nuk e quajti të arësyeshme të vejë ndonjë shënim. Gjithë sa thamë për analogjinë dhe për „Katër stinët”. Por pavarësisht nga mungesa e një pohimi të drejtpërdrejtë nga ana e Nai-

mit, mund të themi se disa veçori të përmbajtjes së veprës na japin të drejtë ta quajmë „Katër stinët” një përshtatje të lirë. Gjejmë në të elemente që na kujtojnë tërthorazi realitetin turk, ku jetonte poeti, tipare të psikologjisë e të ambientit fanatik që i ndrydhte e i shtypte ndjenjat e të rinjve: Në novelë përsëritet herë pas here laitmotivi i njohur i poezisë orientale: dashuria e bilbilit me trandafilin. Lulet që përmenden shpesh janë lulet karakteristike të lindjes, si trandafili, karafili, zybyli, jasemini, borziloku etj. Dashuria e dy të rinjve jepet vazhdimisht në një sfond lulesh e përgjithësisht me një florë të pasur, që të kujton florën e disa vendeve orientale. Edhe nga pikëpamja e perceptimit poetik të jetës gjejmë figura karakteristike për mentalitetin e ambientit ku jetonte Naimi. Kështu, dashuria është përfytyruar si gjarpër, apo zemra e prekur nga dashuria përfytyrohet me tela apo fusha e shtruar si qilim e qielli si çarçaf etj.

Për një punë deri diku origjinale flasin dhe disa veçori kompozicionale e stilistike të veprës. Mënyra se si janë thurur episodet, thjeshtësia e kompozicionit, gjuha e thjeshtë, disa nuanca stilistike etj., e afrojnë „Katër stinët” me Naimin. Siç do ta vëmë re ajo është pjellë e klimës letrare të kohës dhe nuk e kalon stadin e letërsisë së vendit ku jetonte e krijonte shkrimtari ynë.

## II

Novela „Katër stinët” është një tregim lirik ose më mirë të themi një poemë në prozë kushtuar dashurisë. Ajo nuk ka subjekt në kuptimin e mirëfilltë. Vendin e subjektit e zë përshkrimi i dashurisë së dy të rinjve, duke pasur në sfond natyrën gjatë katër stinave të vitit. Heronjt e tregimit janë kryesisht, një vajzë e një djalë pa emër. Edhe vendi ku zhvillohet idili i tyre jepet pa adresë konkrete, diku në gjirin e natyrës. Bile dhe jeta është dhënë në kufi në mes të realitetit dhe ëndërrës.

Por në zbulimin gradual që i bën dashurisë, në përshkrimin e metamorfozave të saj në të katër stinët e vitit, autori ka hequr gjatë tërë veprës një paralelizëm në mes të dashurisë së heronjve të tij dhe natyrës që arrin deri në abstraksion.

Kjo sigurisht lidhet me atë tendencë të njohur të romantikëve, të cilët, në krijimin e figurave, i largoheshin qëllimisht karaktereve të gjallë, tipareve e situatave konkrete, duke i kthyer kështu ato në simbole e përgjithësisht në figura alegorike. Pak a shumë një praktikë të tillë do ta gjejmë të shprehur dhe në „Katër stinët”.

Në themel të novelës janë vënë dashuria dhe natyra, si burime të gjalla të kuptimit e të gëzimit të jetës së njeriut mbi tokë. Ato janë përshkruar me hollësi përmes një pasurie të madhe detajesh të imta që të kujtojnë shpesh punën e endur në filigram. Dhe pava-

rësisht nga fakti se deri në ç'shkallë janë origjinale, prapë ato e zbulojnë Naimin që në atë kohë si artist mjaft të hollë, hetues të imtë të botës së brendshme të njeriut e vrotues aktiv të natyrës. Marrë nga kjo pikëpamje lexuesi habitet me variacionin e madh të përshkrimeve të natyrës dhe të psikologjisë së njeriut të dashuruar. Një gjë e tillë s'ka si të mos zgjojë interes e të mos ngjallë kënaqësi të vërtetë estetike.

Dashuria e dy të rinjve na jepet në tregim kryesisht nëpërmjet shetitjeve që ata bëjnë në gjirin e natyrës gjatë katër stinave të vitit. Ideja e veprës duket sa konkrete aq edhe alegorike: dashuria, ashtu si natyra ka stinët e saj, që nuk varen nga vullneti i njeriut. Këtë ide autori rreh të na e vërtetojë duke na e përshkruar idilin e të rinjve hollësisht në kohë të ndryshme.

Shetitja e parë e dy të rinjve ndodh në pranverë. Ashtu si çelet natyra, çelet dhe dashuria e tyre. Si në një fokus zbulohet para lexuesve lindja e kësaj ndjenje të fuqishme, trazuar me dëshira të vagëlluara e dyshime, me druajtje e heshtje, me buzëqeshje e zëmërimë të lehta. Duket sikur gazi e brenga nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin. Është ajo fazë e dashurisë kur ka shumë dëshira dhe pak guxim, kur ka tundime, po ka dhe maturi nga mungesa e përvojës.

Dashuria na përshkruhet si një vuajtje e ëmbël që buron nga një kontradiktë e fortë psikologjike: nga një anë është dëshira e madhe e të rinjve për t'u afruar, por nga ana

tjetër, forca e zakonit, druajtja e turpi.

Të dashuruarve u mungojnë fjalët. Koha më të shumtën e herës u kalon në heshtje. Bile edhe kur shkëmbejnë ndonjë fjalë, autori nuk na i jep ato. Efektin e fjalëve na i tregon nëpërmjet pamjes së tyre, gjesteve, lëvizjeve, qëndrimit.

„Fjalët e dashurisë nuk mund të kuptohen. Këtë të fshehtë vetëm ai që e thotë e ai që e dëgjon mund ta kuptojnë”.

Fjalët e dashurisë krahasohen me cicërimat e zogjve, të cilat, për ne, nuk kanë kuptim, por janë të këndshme dhe na prekin zemrën.

Gjendja psikologjike e heronjve të tregimit është dhënë në harmoni të plotë me natyrën. Natyra kudo shërben për evidencimin e dashurisë. Kështu, tërë ajo lektisje ndjenjash e endjesh, dëshirash e endërrash jepen duke pasur si sfond pranverën, që lulëzon rreth e qark.

Në pranverë, me ringjalljen e natyrës don të thotë autori zgjohet më mirë se asnjëherë dhe dashuria. Prandaj, pranvera dhe dashuria merren të lidhura ngushtë, përshkruhen të gërshetuara me njëra-tjetrën. Ndjenjës optimiste të dashurisë i është vënë peisazhi pranveror plot dritë e ngjyra, me variacione të ndryshme. Kudo që shetisin të rinjtë, në fusha e pyje, pranë krojeve e lumejve, ndjehet e preket pranvera. Kjo është arritur jo vetëm në përshkrimin e hollë e piktoresk të florës së pasur dhe të këngëve të zogjve, po dhe të natyrës përgjithësisht, të diellit dhe të qiellit,

të reve dhe të erës në çaste të ndryshme të ditës e të natës.

Takimet e shetitjet e dy të rinjve në stinën e verës zënë pjesën më të madhe të novelës. Marrëdhënjet e trye në këtë stinë janë dhënë të plota dhe konkrete. Dashuria është bërë më e fuqishme. Tani ata nuk kanë frikë të afrohen, përkundrazi, të ndezur e të dallisur nga zjarri i dashurisë nuk dinë të shkëputen nga njëri-tjetri. Janë mbyllur në një dhomë dhe kjo i ka dhënë autorit dorë të na i përshkruajë heronjt më afër. Kjo është një pamje që ndryshon nga tabloja idilike e pranverës. Ndjenjat e dëshirat tani nuk janë të vagëlluara apo të ndryshura. Ato janë paraqitur të gjalla dhe të lira. Në mënyrë të veçantë, na jepen me radhë tiparet fizike të vajzës, herë me ngjyra delikate, herë me një notë sensualizmi. Si vajza dhe djali paraqiten shumë të ndjeshëm, të ngarkuar me emocione të forta. Gjëja më e vogël i prek, aq sa dhe bukuria e muzgut të mbrëmjes ua mbush sytë me lotë. Flasin pak, për të mos thënë hiç. Më shumë kundrojnë njëri-tjetrin. Po në ndryshim nga pranvera, ata tani shohin dhe pëllumbat që fluturojnë, ndjekin me sy dhe zogjtë e tjerë, vërejnë lulet përqark, pinë verë e hanë pemë. Dhe kjo nuk është bërë pa qëllim ata janë në verën e dashurisë, gëzojnë frutat që qe kjo stinë!

Kur dashuria e dy të rinjve është në kulmin e saj, pa pritur i futen disa elemente që krijojnë një atmosferë pasigurije e skepticizmi, bëjnë të ndjehet „diçka e çuditshme, si

një shtatore trishtuese". Dëgjohen të këndojnë zogj ndjellëkeqës si kukuvajka e bufi, shihet një skifter që i sillet përçark çiftit. Lihet përshtypja se diçka po e kërcënon dashurinë.

Me futjen e këtyre elementeve novela nga kuptimi konkret merr një kuptim alegorik. Tani vëmendjen e lexuesit nuk e tërheq vetëm përshkrimi i marrëdhënjeve konkrete të çiftit, po dhe ajo tendencë filozofimi që nis të ravijëzohet këtej e tutje në tregim.

Në përshkrimin e vjeshtës tendenca e filozofizmit thellohet më shumë. Autori i largohet gjithnjë e më tepër përshkrimeve konkrete dhe flet me gjuhën e alegorisë.

„Lulet tani nuk dolën gënjeshtarë — u thonë heronjve frutet e pemëve — Po ju që u lulëzoi dashurija, ku i kini frutet?”

Autori pohon se gëzimet që sjell dashuria, si çdo gjë në botë, nuk janë të përjetshme. Ato vijnë dhe ikin si pëllumba që zënë fole në zemrën e njeriut e pastaj largohen. Këtë fillojnë ta ndjejnë dy të rinjtë në stinën e vjeshtës:

„Dashuria që i kish bërë ta donin njëri-tjetrin, që i kish bërë të gëzuar, që ua kish treguar të bukur e të dashur botën dhe jetën e tyre dhe që u kish dhënë lumturi e rrojtje pa andralla, pra kjo dashuri ishte më të fluturuar si pëllumbi dhe zemrat e tyre, që ishin çerdhe e këtij pëllumbi, po mbeteshin shkretë”.

Të dy të rinjtë tani na paraqiten të tërhequr në mendime, të ftohtë, të prekur nga brenga e dhimbja.



„Ata kishin humbur pa shkak gëzimin e parë. Ishin zhyrtur në ca mendime që po i trishtonin që të dy. Po bëheshin përherë e më të brengosur, më të drobitur”.

Sipas autorit dashuria e tyre kishte lulëzuar në pranverë, por nuk kish lidhur kokra, prandaj s’kish si të jepte frute në vjeshtë. Ftohja e dy të rinjve është dhënë shumë qartë në sfondin e peisazhit të vjeshtës.

Në pjesën e fundit jepet mbarimi i dashurisë dhe kjo përkon me stinën e dimrit. Djali dhe vajza tani janë ftohur krejt. Zemrën e tyre e ka mbushur brenga e dëshpërimi. Ata kanë ardhur në vendet ku shetitën dikur të kërkojnë gjurmat e kujtimeve të dashurisë. Po këto gjurma nuk i gjejnë gjëkund. Atëhere qajnë po s’janë në gjendje ta kthejnë dashurinë e humbur.

„Dashurija — thotë djali — ashtu si erdhi pa na pyetur ne, ashtu s’na mori leje edhe kur iku. Ajo jetoi në zemrat tona aqë sa mund të rrojë një trandafil në mes gjethesh ble-roshe”.

Alegoria në pjesën e fundit sa vjen e zotëron në novelë. Ndjehet një frymë fatalizmi që shprehet në faktin që heronjt tani nuk e kanë veten në dorë. Ata duan dashurinë, po s’janë të zot të duan njëritjetrin.

„Zogun e dashurisë që është më të fluturuar nuk janë në gjendje ta mbajnë”.

Për t’i theksuar më mirë idetë edhe në këtë pjesë, përsëri një rol të dorës së parë luan përshkrimi i natyrës. Natyra është dhënë e shkretë. Gjithë gjallëria e bukuria e sti-

nëve të tjera tani është zhdukur nën dëborë. Qiellin e kanë mbuluar re të zeza. Era ulurin përçark. Dalëngadale po vjen nata.

„Bota s'ish asgjë tjetër, veç dëborë e re të zeza, heshtje e thellë. Brenda në savanin e tokës shtrihej kufoma e të ftohtit”.

Me këto fjalë mbyllet tregimi për dashurinë.

### III

S'ka dyshim se nga gjithë sa përshkruam më lart kuptohet se „Katër stinët” është një vepër tipike romantike, qoftë nga brendia, qoftë nga fryma, qoftë dhe nga mjetet e trajtat e saj.

Në Turqinë feudale, në vendin e fanatizmit mesjetar, ku liria e dashurisë apo dhe shoqërimi i lirë i vajzës me djalin ishte një shkelje flagrante e normave morale sunduese, një vepër si „Katër stinët”, i kundërvihet vetvetiu letërsisë obskurantiste myslimane që predikonte robërinë e gruas, asketizimin dhe ndrydhjen e ndjenjave. Me frymën e saj humanitare e tokësore, ajo përbënte një kontribut në letërsinë e re që sapo kish marrë krahë.

„Katër stinët”, ruan në vetvete disa nga veçoritë karakteristike të letërsisë romantike të shekullit të kaluar. Në radhë të parë tregimi është ngritur mbi një tipar të njohur të romantizmit. Në bazën e tij është vënë kulti i ndjenjave dhe i natyrës. Gjithë synimi është të zbulohet bota e brendshme e heronjve, da-

shurija e tyre në faza të ndryshme, e dhënë me tërë nuancat e variacionet. Dashuria është ndjenja e vetme që sundon tek ata.

Heronjt e novelës nuk janë natyra kryengritëse që t'u ngjajnë figurave të Bajronit apo të Shelit, po përgjithësisht përkojnë me natyrën e zakonshme të herojve romantikë të kohës. Të arratisur nga arena e shoqërisë, larg problemeve të kohës, ata tërhiqen në gjirin e natyrës ku jetojnë në botën e lekturës të ndjenjave.

Rrallë e tëk dhe shkarazi na zbulohet ndonjë kënd i jetës, po dhe atëhere na jepet i idilizuar. Kështu fjala vjen kur të rinjtë dalin jashtë qytetit, thuhet se „Fshatarët kishin filluar punën me dëshirë e me zell të madh”.

Heronjve të novelës nuk u intereson asgjë, veç ndjenjave të tyre dhe soditjes së bukurive të natyrës. Nga kjo pikëpamje gama e pasqyrimin të jetës është mjaft e kufizuar. Por nuk duhet të harrojmë që duke përshkruar botën e ndjenjave, atë sferë të jetës shpirtërore që letërsia fetare myslimane e kish përjashtuar, letërsia romantike, në një vend ku sundonte fanatizmi obskurantist, luante një rol përparimtar.

Në këtë vështrim dashuria, si një ndjenjë jetësore, e paraqitur në vepër me forcë e vërtetësi, përmes situatash e hetimesh psikologjike, kishte një vlerë ideo-estetike për lexuesin që jetonte në atmosferën mesjetare anadollake.

Për këtë mund të sillnim disa shembuj. Ja si përshkruhet fillimi i dashurisë:

„Ecnin që të dy duke shkelur mengadale mbi qilimin që ishte shtruar sipër tokës dhe që ish stolisur me lule gjithëfarësh. Para syresh, në mes të aqë drunjve laraganë ishte hequr një shirit i kaltër dhe i pafund, i hollë dhe i bukur, transparent dhe i ndritur, që rrëmbente zemrat dhe që i vërtiste shpirtrat poshtë në shtjelljen e ndjesivet të thella e të endëshme. Duke kaluar nën retë e bardha si dëborë dhe përmes luleve të bajamevet që ndodheshin nën dy anët e rrugës, ata po fluturonin si engjujt e erës”.

ose

„Ashtu, si zogjtë, të cilëvet u zihet fryma duke qëndruar ngjitur me njeri tjetrin, në një degë të vetme e që çajnë me krahët e tyre ajrin dhe fluturojnë duke e lënë degën të tundet, ashtu dhe ata u ngritën dhe filluan të ecnin, ashtu si trembin gjethet, që tunden nga era, zogjtë e vegjël brenda në foletë, ashtu dhe dashuria, po trembte dhe po shqetësonte zemrat e të rinjve, po frikësonte dhe po trazonte mendjen e tyre”.

Është një çast psikologjik i kapur bukur kur peisazhi i pranverës shërben për të vënë në pah lindjen e dashurisë:

„Retë erdhën dhe u bënë më të dendura. Koha u prish. Mbas pak, filloi menjëherë të binte një shi i rëndë. Të rinjtë u shtrënguan tanimë të ktheheshin me të shpejtë. Ndërsa po ecnin me nxitim, që të dy të rënë në mendime, një qukapik lëshoi papritur përpara tyre një britmë që i bëri të dridheshin që të dy. Duke marrë zemër ngakjo, djaloshi mër-

mëriti diçka po e dashura e tij nuk e dëgjo dot”.

Djaloshi është aq i tërhequr pas vajzës, sa nuk ia ndanë sytë edhe kur ajo fle:

„Tek flinte ashtu e qetë, pa u ndjerë, si reja e bardhë në mes të qiellit të qartë të mbasditës, kur moti ishte i kthjellët, ajo dukej si një lule jasemini në kopsht nën yjet e qiellit...”.

Afrimin e dy të rinjve në verën e dashurisë na e jep shumë bukur nga larg, vetëm nëpërmjet lojës së hijeve:

„Aqë afër njeri tjetrit janë ata, sa shumë herë duken si një hije e vetme. Kjo hije lëviz ngadalë e nganjëherë ajo ndahet, po përnjëherësh bashkohet serish. Mund t'i dallos lehtë tek ecin krah për krah në livadhe. Ash-tu si retë marrin gjithëfarë formash në qiell, ashtu dhe hija, herë ndahet në dy, herë bashkohet në një të vetme, herë duket fare afër, herë pakëz më larg”.

Dy të rinjtë shetisin natën vetëm nëpër pyllin e errët dhe gjendja e tyre përshkruhet me këto fjalë:

„Frika merr trup dhe fillon të endet përçark me një ecje të ngadalëshme dhe të çuditshme, ajo del nga hijet, ulet për të kaluar nën degët e shtëmbëta, ngrihet, prapë qëndron, fillon të dridhet, bredh me vrap, kërcen, hap gojën për të trembur të zotin e saj, hyn kudo, qesh, qan...”

Mjaft i hollë dhe sugjestionues është përshkrimi i ndarjes së tyre:

„Në të vërtetë, mërmërimi i ëmbël i ujit që ridhte nën akujt, i grishte që të qëndronin atje, por shiu i shtrëngonte të iknin. Lladi-gat e drunjve ua kishin zënë rrugën, por era i këshillonte që të ktheheshin. U ndanë tani-më të dy, me një guxim të madh e me një vullnet të rrallë. Sa keq! U ndanë përgjithmo-në! Duke venë secili dorën në zemrën e vet të plagosur e të pikëlluar duke psherëtirë e qarë me ngashërim, rendën secili në një anë... Bërtitnin me trishtim e shumë të trazuar. Zëri i tyre dëgjohej më mirë se vërshëllima e erës së furishme. Por nga dhimbja që t'u la ndarja, asnjëri nuk e dëgjoji njeri tjetrin. Më në fund, asgjë s'po dëgjohej më përveç zhau-rimës së erës dhe të drunjve, të uturimës së ujrave e të maleve. Dielli u nxi dhe u bë ste-rrë, dëbora nisi të bjerë serish. Plasi një shtrëngatë e madhe, një stuhi e jashtëzakon-shme”.

Në novelë gjejmë mendime interesante, konstatime të holla që zbulojnë anë të reja të botës poetike të Naimit:

„Bukuria që është në të mbaruar nuk ndryshon në dukje nga bukuria që po fillon, ashtu si nuk ndryshon edhe dashuria që po zë fill nga dashurija që është në të shterur e sipër. Por bukurija dhe dashuria që janë në të mbaruar janë më tërheqëse, më të reja..”.

„Perëndimi i dashurisë po bënte që atyre t'u kthehej sërish dashuria e dikurshme”.

„Humbja e lumtërisë ishte e hidhur dhe pikëlluese vetëm sepse njeriu kujton çastet e ëmbëla të dashurisë”.

Novela është e mbushur plot me përshkrime të bukura të natyrës. Natyra na paraqitet jo si një dekor i thjeshtë, po si pjesë përbërëse e veprës, në funksion të zbulimit të botës së brendshme të njeriut. Pamjet e saj janë aq të shumta e të larmishme, sa lexuesi ndjen një kënaqësi të thellë estetike. Pejsazhi i fushës, pamja e pyllit dhe e kroit, loja e reve dhe erës, lulet dhe drurët, dielli dhe hëna, të gjitha këto të vështruara në të katër stinët e vitit ditën dhe natën i gjejmë në tabllotë e panumërta të natyrës në novelë.

„...e kish rrëmbyer vija e kroit që rridhte ngadalë, në mes lulesh duke murmuritur e duke thënë kaq të fshehta, si dhe përroi që vinte me buçime të potershme nga shkëmbinjtë e lartë”.

ose

„atë e kish mahnitur dhe përpirë madhështia e rëndë e malevet, hijeshia e natyrës, stolitë e derdhura mbi faqen e tokës, ngjyra e ëmbël dhe e dashur e kupores së qiellit”.

ose

„Ushtria e reve po rendte me vrap ku qielli si një vashë me fustan të kaltër po zbulonte ngadale fytyrën e vet”.

Të një natyre poetike, plot delikatesë e hijeshi janë dhe portretet në tregim p.sh. „Balli i saj që s'donte t'ia dinte erës ishte dhe më i bardhë se dëbora e grumbulluar në rrezet e malit... Shikimi i saj rrëronte çdo zemër... Leshrat e rënë mbi supe e qafë i shëmbëllenin dallgëve që bien mbi një gur mermeri që ndodhet në breg të detit”.

Gjejmë figura të bukura që e ruajnë freskinë e tyre dhe në ditët tona:

„Lulishtja (në stinën e vjeshtës N. J.) i shëmbëllente fytyrës së një njeriu që ka qenë me ethe”.

Ose

„Këmisha e hollë si tymi i shëmbëllente dallgëve që ngre era e veriut në faqen e detit...” ose

„Boria e fundit e vjeshtës kishte mbledhur ushtrinë e dashurisë, kurse era e saj e kish shpërndarë krejt këtë ushtëri”.

Krahas spiritualizmit, përshkrimet e bukurisë shpirtërore të heronjve, në novelë ndjehen me nota sensualizmi. Kjo duket në vizatimin me hollësi të tipareve fizike, e veçanërisht të atyre tipareve që zgjojnë afrim reciprok. Në këto raste tregimi për dashurinë bëhet akoma më konkret, më tokësor.

„Katër stinë”, siç e përmendim më lart, duke qenë pjellë e klimës romantike të kohës, nuk i ka shpëtuar një lloj fryme fataliste. Në qoftë se në pjesën e parë e të dytë kjo pothuajse nuk ndihet dhe nuk lot ndonjë rol, në pjesën e tretë e të katërt, ku tendenca e filozofizmit, kuptimi alegorik zotëron, fryma fataliste zë një vend me rëndësi. Ajo shprehet në idenë që dashuria e lumturia janë të kërcënuara vazhdimisht nga fuqia e errët e fatit:

„fati ja mori serish me të përdhunë e pa ndonjë shkak lumturinë që i kish dhuruar”

„ato kishin humbur pa ndonjë shkak gëzimin e parë”,



„ata e donin dashurinë, po nuk qenë të zot të donin njeri tjetrin”.

Sipas autorit një forcë e fshehtë, e paraktuar, pasi i bëri djalin e vajzën të gëzojnë dashurinë në pranverë e në verë, i ftohu, gradualisht në vjeshtë dhe i ndau me përdhunë në dimër.

Është pikërisht kjo frymë fataliste një nga ato veçori që e bashkon novelën me letërsinë romantike të kohës.

Por novela na duket se largohet nga koncepti i njohur i romantikëve mbi dashurinë, që e merr atë si të përjetshme. Në „Katër stinët” dashuria konceptohet si një fenomen që lind, zhvillohet e vdes.

Siç vihet re, domethënja filozofike e veprës ishte kontradiktore, autori nuk është konsekuent në pikëpamjet e tij. Nga një anë, pranon ekzistencën e një force të fshehtë, fuqinë e fatit në jetën e njeriut, nga ana tjetër, gjykon në mënyrë dialektike në trajtimin e një fenomeni njerëzor, siç është dashuria. Kuptohet se ky lloj ekletizmi me domethënjen filozofike të veprës shpjegohet në përgjithësi me vetë kontradiktat themelore të botëkuptimit të Naimit.

Në përfundim, mund të themi se „Katër stinët”, për frymën dhe karakterin që ka, për idetë dhe brendinë e saj, zë një vend të veçantë në fillimet romantike të poetit tonë. Kjo është e para vepër, me sa dimë deri më sot, që e lidh Naimin me romantizmin, me këtë rrymë të fuqishme letrare, që do të vërshojë më vonë me tërë krijimtarinë e tij.

Sigurisht „Katër stinët” është hapi i parë i poetit tonë drejt shkollës së re letrare, por kjo ka rëndësi sepse duke përqafuar këtë shkollë, ai do të shkëputet nga modelet e vjetra letrare, nga letërsia anakronike, do ta drejtojë vëmendjen nga njeriu dhe jeta e gjallë, nga bukuritë e natyrës dhe kënaqësitë tokësore.

Romantizmi i hapi horizont Naimit edhe në pikëpamje të pasurimit të mjeteve letrare, i zgjeroi kufijt e formës artistike. Gama e gjerë e jetës, bota e pasur e ndjenjave dhe e mendimeve njerëzore, sferat e reja të njohjes nuk mund të jepeshin më me mjetet e vjetra letrare, me bagazhin e varfër artistik të letërsisë së atëhershme. Metoda e re e bëri Naimit të çmojë më shumë vlerën e verbit poetik, të njohë nëntekstin, të pasurojë sistemin figurativ e sidomos me simbolin, të përdorë lloje të reja të vargut etj.

Novela „Katër stinët”, megjithëse nuk trajton ndonjë problem konkret të shoqërisë së kohës, ai dëshmon nga një anë për interesat e Naimit, për kulturën e tij, për ndjenjat e holla dhe mendimet që e shqetësonin, dëshmon nga ana tjetër se duke kaluar nëpër shkallën e parë të romantizmit, poeti ynë do ta ketë më lehtë ta lidhë poezinë e tij me lëvizjen kombëtare, për ta bërë atë pasqyrë të saj, pasqyrë të botës shqiptare dhe të vetë njeriut shqiptar.

Duke përfunduar, do të deshim të shtojmë, se në këtë artikull, u përpoqëm vetëm të jepnim disa të dhëna mbi veprën deri tani

të panjohur të poetit tonë dhe të hidhnim disa mendime që sugjeron ajo me studimin e parë.

*Nasho Jorgaqi*

---

*Shënim* — Për studimin e novelës „Katër stinët” u mbështetëm në përkthimin e Vexhi Buharasë që ndodhet në Arkivin e Institutit të historisë dhe të gjuhësisë.

PRANVERA

## 1

Në kohën e mesditës po shëtisnin që të dy pranë e pranë në vendin nga dilnin bota për shëtitje.

## 2

Shiu tashmë kish pushuar. Ta kish ënda të shikoje ngjyrën e kaltër e shumë të bukur të qiellit. Aty-këtu, ca re si elefantë të ngarkuar kapul me pambuk endeshin ngadalë nga një horizont në tjetrin duke i dhënë pamjes një hieshi më vete. Aq shumë afër dheut dukej qielli, sa retë e dendura e të bardha si pambuk në lëvizje binin mbi majat e sukavet dhe të pemëvet, bëheshin copë-copë dhe dukej sikur qëndronin në vend.

Toka, e çelur nga gëzimi, po fitonte sërishtmi freskinë e saj nën afshin jetëdhënës të diellit dhe nën dritën e tij të bukur. Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli.

Era që frynte lehtë bënte që të fërfëllenin vetëm gjethet, pa trazuar fare degët. Duke parë se do të shpëtonte nga dora mizore e

dimrit, Toka po priste gjithë gaz pranverën dhe po ndodhej pranë në të gjitha ndryshimet e mëdha të natyrës. Me një fjalë, Tokë e Qiell po nënqeshin të gëzuar.

## 3

Ecnin që të dy pranë e pranë e mengadalë. Njeri nga frika se mos nxirrte në shësh ndjenjat e zemrës së brishtë<sup>1</sup> e besëplotë, shikonte me kujdes me bishtin e syrit; kurse tjetri, për të mos u kuptuar, vështronte nën qepallat si shigjeta të syvet të tij magjiplotë. Në buzët e të dyve spikasëte një nënqeshje e lehtë. Kur shikonte, vashën t'i valavitej fustani gjatë shëtitjes, djaloshtit i vlonte gjaku përbrenda. Ah, pranverë, agim, kohë e djalërisë, dashuri!

## 4

Që të dy, nga koka gjer te këmbët, ishin plot shije e bukuri; kraharorët e tyre ishin mbushur me hir e me ëmbëlsi, me miqësi e dashuri. Meqë djaloshtit s'kish guxuar gjer tashiti t'i thoshte qoftë edhe një fjalë të dashurës së tij, e vështronte atë nga larg, ashtu si shikon lundërtari duke u dridhur te timoni yllin që vezullon lart në qiell.

---

1) i brishtë = nazik

Ja, pra, dita e verës<sup>2</sup>, ashtu si bashkon njëri me tjetrin zogjtë që kthehen nga viset e dimërimit, bashkoi edhe të rinjtë dashnorë te ky vend këtu. Sadoqë ishin që të dy të njomë dhe të padjallëzuar, ata e dinin se, duke dashuruar njëri-tjetrin, do të shkaktonin lotë në sytë ziliqarë dhe urrejtje e armiqësi në kraharorët resëtarë. Mirëpo, s'e kishin dot në dorë që t'u bënin ballë ndiesivet të furishme të dashurisë. Sa herë që kryqëzoheshin shikimet e tyre, ata ndjenin përnjëherësh në kraharorët shigjetat e engjëllit të dashurisë, gjë që e dinë aq mirë ata që dashurojnë.

## 5

Sa keq! nënqeshja e ëmbël e pranverës i hodhi në fatkeqësi të rinjtë zemërdlirë. Ndërsa ata shëtisnin, ajri i kulluar, zërat ngazëllues, fërfëllima e lehtë dhe e ëndshme e veriut, ligjërimet dhe tingujt e zogjvet dhe natyra me tërë hieshinë e saj, të gjitha këto, duke flladitur zemrat e të rinjvet, i bënin këta më të guximshëm e më të lirë, i shtynin drejt dashurisë së ngrohtë. Engjëlli i patundshëm dhe i padhimsur i dashurisë u ledhatonte, duke qeshur e plot naze, faqet me krahet e tij të paqenë.

Me ardhjen e pranverës, natyra qe stolisur tej zakonit; ajo u falte zemrave ëndje,

2) Kupto: dita e parë e pranverës — (Shqip-ruesi)

vlagë e ngazëllim. Mbasi dielli kishte ngritur mbulesën e bardhë nga toka, dora e natyrës kishte shtruar mbi siprinën e kësaj një qilim laragan. Manushaqja, zambaku, lulet e endshme të bajames, ngjyra dhe era e lulevet që kishin çelur, u jepnin zemravet ngazëllim, mendimevet dritë, shpirtit flladitje.

Fshatarët kishin filluar nga puna me dëshirë e me zell të madh. Zogjtë fluturonin, shetisnin dhe endeshin; ato po vinin tëmotjen<sup>3</sup> e tyre. Me një fjalë, duke shfaqur nga çdo anë dashurinë dhe lumturinë, jetën e qetë e pa brenga, me jonet, me erën e dashur, me nënqeshjen, ngjyrën, shkëlqimin dhe madhështinë e saj, natyra po tregonte hieshinë e saj të ëndshme.

## 6

Më kot ligjëronin zogjtë! Më kot manushaqja, e fshehur në mes të barit të gjelbër, tregonte me naze e përgjysëm shtatin e saj. Nënqeshja e ëmbël dhe e dashur e natyrës nuk po u bënte asnjë përshtypje të rinjvet tanë. Pa hedhur sytë fare përçark, ata shikonin vetëm njëritjetrin, duke qenë të përmbytur në vorbullën e një mendimi të vetëm dhe në ingjirin e një andralle të panjohur. Zemrat e tyre ishin mbushur vetëm me dashuri. Çdonjeri syresh mendonte vetëm tjetrin.

3) Tëmotje (rregullisht në numrin shumë) = zahire, nozullime.



## 7

Megjithatë, era e dashur e lulevet të verdha të thanavet, e lulevet dëborë të bardha të kumbullavet, të pjeshkëvet, të bajamevet dhe e luleve të larme të pemëvet të tjera që ishin përçark, po i dehte dhe po ua mirrte mentë të rinjvet. Ecnin që të dy duke shkelur me ngadalë mbi qilimin që ish shtruar sipër tokës dhe që ish stolisur me lule gjithfarësh. Përpara syresh, në mes të aq drunjve laraganë, ishte hequr një shirit i kaltër dhe i pa-fund, i hollë dhe i bukur, i tejqyrshëm dhe i ndritur, që rrëmbente zemrat dhe që i vërtiste shpirtërat poshtë në shtjelljen e ndiesivet të thella e të ëndshme. Duke kaluar nën retë e bardha si dëborë dhe përmes lulevet të bajamevet që ndodheshin në të dyja anët e rrugës, ata po fluturonin si engjëjt e erës.

Më në fund dolën nga vendi i shetitjes dhe morën rrugën e përdredhur të një kalaje të vjetër. Tashti djaloshi, duke marrë pak guxim, mërmëroi ca fjalë me zë të dredhur. Dhe e dashura ju përgjegj me një nënqeshje që dilte nga dliresia e shpirtit dhe të ritë e saj, nga guximi dhe nga ndjenja e turpfit.

Meqë udha ishte shumë e ngushtë, ajo ruhej me kujdes nga drizat që ishin anës, jepej ashtu si jepet qiparisi nga era e vrullshme. Megjithatë, i ngecën se i ngecën bufkat<sup>4</sup> në gemin e një shkurre me gjemba. Nxori padashur një zë që jepte të kuptoje se

4 Cullufet

ajo kërkonte ndihmë. Duke prekur mengadalë ato bufka të bukura të së dashurës, të rrahurat e zemrës së djaloshit u shtuan edhe njëherë më shumë dhe dora ju drodh gjatë si purtekë. Sidoqoftë, atij i qeshi e gjithë fytyra nga kjo fitore e madhe. Dy pëllumba, që po shikonin të gjitha këto, u shkrihën dhe filluan të guatnin mbi majën e drurit ku kishin qëndruar.

## 9

Shqetësimi dhe trazimi që po dërmnin me të rrahura të forta kraharorët e të dy dashnorëvet po ngjizeshin edhe në natyrë e në qiej. Pranvera donte të shpëtonte nga duart e dimrit të ashpër e të egër, por më kot mundohej. Retë e zeza po u suleshin pa dhemshuri rrezetvet të diellit botëshëndritës dhe duke i zhdukur këto, po dhëmkosnin faqen e tokës që sapo kish filluar të qeshte, po linin me kokë ulur drunjtë dhe po pikëllonin kopështin me lule.

Si dukej, djalli i dimrit duke mos duruar dot hieshinë e engjëllit të pranverës që i zuri vendin, kërkonte të rrëronte botën me pallën e shpartallimit.

Dy të rinjtë, duke parë këto, pa folur me njeri-tjetrin dhe me një brengë e dëshpërim që u mbështillte si re zemrat, po mendohehin që të ktheheshin. Por meqë rrezet e diellit, duke dalë papritur që prapa perdes së revet dhe pa i dalë dimrit në sy, zbritën sërisht në tokë, ata vendosën që ta vazhdonin

rrugën. Ja, pranvera, ashtu si po ndërtonte rruzullin e dheut, po joshte dhe po ngazëllonte edhe zemrat e të rinjve, që ishin si lule të sapoçelura.

## 10

Rruga dilte në një livadh të gjerë. Siprina e livadhit ish si një kadife bleroshe që farfurinte aq shumë, shtruar nga dora e brishtë e engjëllit të asaj pranvere të bekuar. Djaloshi ndiqte pas si hie të dashurën e vet pa thënë asnjë fjalë. Ndërsa këta kalonin urëzën e përroit që rridhte shumë ngadalë përmes livadhit, nëpër shelgjet anës përroit ligjëronin mijëra trumcakë që hidheshin nga një degë në tjetrën dhe fshiheshin në mes gjethesh të dendura. Vetmi e thellë... nuk të zinte syri asnjë njeri atje. Në kohën që dy të rinjtë po ecnin me shumë ngut, kokëulur, sikur të kishin bërë ndonjë faj, në mes të gjethevet që dridheshin nga era e lehtë e plepave të gjatë, delmerja<sup>5</sup> ja mori një kënge që ç'të të them. Asohere djaloshi, flakë i kuq në fytyrë, i shtërrënguar nga vetëvetja, deshi sikur t'i thoshte nja dy fjalë së dashurës së tij. Por nga turpi fjala i mbeti në fyt dhe mendimet i mbetën në tru. Prandaj, i turpëruar edhe njëfish më tepër, ai u nxeh me veten e tij që s'dinte dhe që i mungonte guximi.

---

5) Bishtshkundësi

## 11

Më në fund arritën te kroi. Vasha u ul mbi një sop që ish përkundrejt kroit, kurse djali zuri vend përballë saj, i heshtur pa guxuar ta shikonte atë në sy dhe pa i thënë asaj as edhe një fjalë. Megjithatë, ashtu si heshtja e tij tregonte kaq gjëra, ashtu edhe qëndrimi dhe sjellja e tij zbulonin gjer në një farë pike ndjenjat e tij të brendshme. Duke parë vasha gjendjen e përgjithshme të dashnorit të saj, fytyrën që i ish venitur dhe kraharorin që i ngrihej dhe i ulej me vërtik duke nxjerrë psherëtima të gjata, e vështronte atë me dhëmshuri, por nga turpi dhe ndjenja e nderit s'guxonte të nxirrte zë dhe bënte sikur s'dinte gjë. Nga ky qëndrim i së dashurës djaolshit ju mbush mendja se ajo nuk e donte dhe se e vështronte këtë pa ndonjë qellim, prandaj tha: „Ah, të mundja ta shkulja zemrën time nga kraharori që më është bërë akull i ftohtë dhe që më rreh me vërtik dhe t'ja vija asaj përpara qeta bëja të mësonte se si qendron puna!”.

## 12

Por ndjenjat e vashës ishin larg nga tallja dhe mosçarja e kokës. Qëndrimi i mësipërm i saj vinte vetëm nga ndjenjat e turp-it, që është tipar për këtë moshë. Fytyra e saj e ëmbël vërtetonte se ajo ishte e dhimsur dhe e pafajshme, me zemër si të deles, të dlirtë e të çiltër, sjellja e saj e ëndëshme tregonte ha-

pur se ajo ishte e kënaqur nga jeta dhe e lumtur me bukurinë dhe hieshinë e saj, ecja e saj e bukur të thoshte se asaj gjer diku ja kish ënda të mundahej që të rrëmbente zemrat e të tjerëvet. Vetëm se ndjenjat e zemrës ja zhdukte turpi: prandaj, që të mos shikonte në sy dashnorin, hidhte vështrimet për-qark dhe pa luajtur nga vendi trazonte me dorën e vockël lulet dhe gjethet që kishte pranë. Vesku dhe hieshia, bukuria dhe ëmbël-sia e saj ishin si një gjethe<sup>6</sup> e natyrës së stolisur me hirin e pranverës. Kur qëllonte që vështrimi i saj të ndeshej me atë të dashnorit, ulte qepallat e gjata duke dashur të tregonte me këtë se kërkonte të fashitëte zjarrin që ndjente në sytë e saj të ëmbël. Aq shumë të zënë i kish sytë dhe veshët, sa nuk po mundej të fliste sikur edhe një fjalë të vetme. Sepse vëmendjen ja tërhiqte bukuria e pamjes që shtrihej përpara. Të gjithë aftësinë e saj për të dëgjuar e kish rrëmbyer vija e kroit që rridhte ngadalë në mes lulesh dhe livadhit të blearuar duke mërmëruar e duke thënë kaq të fshehta si edhe përroi që vinte me buçimë të potershme nga shkëmbinjtë e lartë. Ja, këto pamje po sodiste ajo tashti e mbytur në mejtime të thella; atë e kish mahnitur dhe përpirë madhështia e rëndë e malevet, hieshia e natyrës, stolitë e derdhura mbi faqen e tokës, ngjyra e ëmbël dhe e dashur e kupores së

---

6) gjedhe = model, mostër.

qiellit. I gjithë vendit përqark s'ish veçse këngë e jone të ëmbëla, gjethe, lule, erëra të endshme, blerime, rini, pranverë, nënqeshje dhe shpresë. Por ç'e do! Drojtja që vinte nga qendrimi i rëndë dhe krenar i vashës dukej si një gardh i hekurt i ngritur përpara dashurisë. Duke shikuar me turp e me bishtin e syrit, pa përfillur fare sendet përqark, si gjera të vogla këto që nuk ngrinin peshë, djaloshi nuk ndjente, nuk kuptonte dhe nuk shihte gjë tjetër veç së dashurisë së tij. Pamja e saj e brishtë, bukuria, shikimi dhe buzëqeshja e asaj virgjëreshe të endshme e fshinin fare ëmbëlsinë dhe hieshinë e rëndë të pranverës. Ajo ishte një lule që i tregonte atij njëmijëherë më mirë nga pranvera e çelitur bukurinë e përsosur të natyrës.

## 13

Më në fund vasha u ngrit nga vendi ku kish qenë duke ndenjor. Mbasi kaluan, njeri prapa tjetrit, urën e ngushtë, ata u nisën nga pylli. Për këtë qëllim morën një rrugë të gjerë që shkonte drejt nga mesi i pyllit, që fshihej në mes gjethesh plot hie të kulpravet dhe të drunjvet të dendur që ndodheshin në të dyja anët e rrugës dhe që ishte stolitur me manushaqe e me lule të tjera të merme. Të dyja anët e rrugës nga lulet verdhoshe dukeshin si vilarë atllasi të gjelbër stolitur me ergjënd. Disa nga drunjte i kish ngulur, si-

pas dëshirës së vet, dora e natyrës, kurse di-  
sa të tjerë i kishin rritur dhe radhitur sërë-sërë  
njerëzit me punën e tyre. Me hieshinë e tyre  
këta drunj dëfrenin dhe kendellnin zemrën e  
atyre që i kundronin.

Ç'thoshte era e lehtë me anën e gjethe-  
vet, i përgjigjej mermërimi i ujravet. Fluturat,  
nga frika e armikut të tyre, dimrit, dhe nga  
dëbora e ftohtë, nuk po guxonin ende të dil-  
nin nga folezat për të fluturuar dhe për të  
punuar. Vetëm bleta, si më trimja nga sho-  
qet, kishte dalë më përpara nga të gjitha dhe  
me sa fuqi që kishte po përhapte me zhuzhu-  
rimën e ëmbël kangën e saj të veçantë. Po ash-  
tu edhe zogj gjithfarësh ia thoshin që ç'ke me  
të këngës së ëmbël duke ligjëruar që nga de-  
gët e larta hymne të ëndshëm e të thuruar bu-  
kur që lëvdonin pranverën.

## 14

Duke ecur kështu në hien e drunjvet të  
dëndur, trimi ju afrua së dashurës dhe me  
plot guxim këtë herë i tha nja dy fjalë. Ç'i tha  
vallë? Jehona e pyllit mund ta nxirrte në  
shesh të fshehtë e tij, por pylli nuk e dëgjo  
dot zërin e djaloshit. Pastaj fjalët e dashurisë  
nuk mund të kuptohen. Këtë të fshehtë ve-  
tëm ai që e thotë dhe ai që e dëgjon mund  
ta kuptojnë. Shprehjet e dashurisë nuk janë  
një poezi e ndërtuar bukur, por një poezi  
shumë e ëmbël. Vetëm ky ritëm i ëmbël, i  
ngazëllon zemrat e dashnorëvet. Ky ritëm

është i ëmbël si ligjërimi i zogjvet. Tingujt e zogjvet mbase s'kanë kuptim, po a nuk janë të ëndshëm se? a nuk ta thekin zemrën? Një dashuri e re nuk shpreson shumë gjëra. Ajo mund të ngushëllohet me një gëzim të vetëm. Ata që vuajnë nga dashuria, anën kuptimore të fjalës ua lënë atyre që janë kundër dashurisë, për vete zgjedhin anën e shijshme të fjalës.

## 15

Vasha dëgjoi fjalët e dashnorit dhe u skuq në fytyrë dhe sakaq i hodhi atij një shikim të përzier me ndjendjen e turpit dhe me sjelljen e saj të hieshme, një shikim plot ndjenjë nderi dhe dliresi. Kuptohet nga sjellja dhe qëndrimi i saj se ajo ishte gati të kërkonte sqarime mbi fjalët që dëgjoi për të parën herë. Zëri dhe qëndrimi i djaloshit tregonte hapur se fjalët që kish thënë ai më në fund shprehnin vetëm një dëshirë që kish lindur nga dashuria. Ajo e kuptoi këtë dhe i mbushi me lotë të valë sytë e saj të bukur. Po, trimi donte të shprehte gjendjen e tij, mbresat e tij, brengën dhe dhëmbjen e tij, ndiesitë e tij. Dëshira e dashnorëve është që me anën e fjalës t'u hapin zemrën e dliresë dhe t'u shprehin dashurinë atyre që dashurojnë ata. Vetëm se, po të jetë që natyra nuk e hap krahanorin e këtyre të fundit me ata gishtrinjtë e lehtë e të magjishëm që ka ajo dhe nuk hedh këtu këtë të fshehtë të dashurisë, asohere çdo fjalë



është e kotë. Ndërkohë, duke kaluar pranë plepavet të bardhë, në hien e rrepevet dhe përmes trendafilash, ata u gjendën papritur përpara njëporte. Vasha, si për të treguar se nuk e dëshironte dashurinë dhe shoqërimin e dashnorit të saj, që ish bërë veri pas saj, shtyti me zemërim e me të shpejtë portën dhe doli matanë. Mbasi doli edhe shoku që e shoqëronte vashën, u mbyll porta. Vasha mori frymë lirisht, sikur të kish dalë nga një vend mundimi. Por dashnori i saj, duke kujtuar se mos e kish mërzitur, u pendua për ato që kishin ndodhur pakëz më parë dhe ju duk se do të kish qenë më mirë të kish vdekur se sa të kish mërzitur të dashurën e tij. Megjithatë, meqë në fytyrën e saj, të cilën e shikoi me vrejte, nuk pa ndonjë shenjë dufi e zemërimi, ai më në fund u gëzua dhe plot me shpresa filloi të ecte përpara asaj pa folur gjë.

## 16

Ikë e ikë arritën mbanë pyllit. Aty u doli përpara një lëndinë e gjerë. Duke soditur këtë fushë, që paraqiste një pamje të bukur, ata ndjenë në zemrat një flladitje të jashtëzakonshme. Sytë u vërtitën në çdo anë, zemrat u joshën, mendimet u qetësuan dhe shpirtërat u ngazëlluan. Secila pikë e pamjes që u shtrihej përpara bënte që t'u lindte në shpirt një mbresë më vete. Livadhi që ishte aty afër rreniente si smerald; më tej një varg sukash tërhiqnin dhe ngazëllonin nga larg zemrat e

tyre, që ishin mësuar të kuptonin hieshinë dhe artin e thellë të natyrës; kurse malet e larta, që dukeshin edhe më tej, i jepnin shpirtit një flladitje të veçantë. Vështrimet e tyre, që humbinin tej në veri në një pyll të rrethuar me durnj, u linin në shpirt një mbresë më vete.

Kuporja e qiellit dukej shumë e lartë dhe horizonti nga të gjitha anët dukej i gjerrë sa s'ish ku të vinte më tej. Disa re të murrme, duke u vërtitur dalëngadalë aty-këtu në qiell, ndryshonin formën e tyre kaq herë brenda një hopi.

## 17

Gjatë rrjedhës së lumit radhiteshin plepa të lartë. Degët e shëlgjemet nuk i lejonin fare rrezet e diellit që të ciknin ujët.

Retë erdhën dhe u bënë më të dendura. Koha u prish. Mbas pak filloi menjëherë të binte një shi i rëndë. Të rinjtë u shtrënguan tashmë të ktheheshin me të shpejtë. Ndërsa po ecnin me nxitim që të dy të zhytur në mendime, një gjel i egër lëshoi papritur përpara tyre një piskamë që i bëri të dridheshin që të dy. Duke marrë zemër nga kjo rrethanë, djaloshi nxori zënë dhe mërmëriti ca fjalë, por e dashura e tij nuk i dëgjoji dot.

## 18

U ulën nën një dru të gjelbër që të çlodheshin pak. Pa folur asnjë fjalë, ata dëgjonin piklat e shiut që binin mbi gjethet. Vendi për rreth drurit bleronte nga bari që ishte plot me manushaqe, Djaloshi u përkul pakëz, këputi ca manushaqe dhe pa folur, me turp dhe si me droje ja dhuroi së dashurës së vet. Duke i pranuar menjëherë manushaqet vasha vuri dorën në jetullën që kish lidhur me leshrat e bukur. Ndërsa prekte manushaqet me duart e brishta, ajo dukej aq e hieshme, aq e ëndshme dhe aq e bukur sa ja mori mendjen fare dashnorit që po digjej për të dhe e bëri këtë që t'i binte ndër këmbë pa e pasur fare veten në dorë. Por vasha nuk i la kohë. Me të parë që hapi moti, ajo brofi në këmbë, dolli në fushë si të ish një manushaqe dhe fluturoi si të ish një vidë. Në fushë blegërinin dhentë e shqerrat.

Çfarë shije ndjente vallë vasha duke shoqëruar djaloshin dhe duke ndenjuri me të? Të vërtetën e kësaj vetëm femrat mund ta thonë. Ky shoqërim ishte një shije e fshehtë e përzier me brengë e me gëzim, një ngazëllim i trazuar me lotë, një fat i panjohur dhe i përkohshëm. Megjithëkëtë, është e vështirë të zbulosh si duhet zemrën e vashavet. . .

Pse të zgjedhë vasha mundimin që i sjell shoqërimi me një djalë? A mos është që të kuptojë mendimet e atyre që i shfaqin dashurinë? Është e vërtetë se njeriu duke menduar në heshtje dhe më vete, mund të argëtohet

dhe të ngazëllohet. Por a nuk është një gjë shumë e bukur të kuvendosh me një shok në një vend të mënjanuar? Vashat me të vërtetë duan që të dashurohen, por fjalët që kanë të bëjnë me dashurinë dhe me marrëdhënjet midis dashnorëve i mërzitin ato. Ah, moj jetë e rinisë! Ah, moj breng e ëmbël! A mos vjen vallë nga qielli? Përse shkon kaq shpejt dhe befas? Ti vyshkesh shpejt si trëndafili, si manushaqja dhe si zymbyli.

Ndërkaq, duke kaluar përmes fushës, nëpër pyll dhe pastaj rrëzës së malit, pa shikuar fare as në rrugë, as përqark, ata kishin rënë në mejtime të thella. Po shëtisnin herë duke u përkulur nën degët e drunjvet, herë duke kaluar nëpër rrugina të ngushta, herë duke dalë në çeltina të gjera. Meqë ishin lodhur, qëndruan për t'u prehur pakëz. Ata filluan të soditnin natyrën e qetë përqark.

## 21

Vasha u ul mbi një gur të stolisur me lule gjithfarë ngjyrash në mes të rrugës. Dashnori i saj vajti dhe u shtri në mes të livadhit i mbështetur mbi brrylat. Koha po zbutej sërish. Ushtria e revet po rendnin me vrap dhe qielli si një vashë me fustan të kaltër po zbulonte dalëngadalë fytyrën e vet. I dashuri i pranverës, ylli që mban gjallë botën, tregoi fytyrën e tij shkrepëtimatre, të fshehur gjer tashti prapa napës së revet.

Të rinjtë, që ishin mbytur në detin e pafund të dashurisë, u mahnitën përnjëmend duke soditur tashti bukurinë e pashoqe të natyrës së bekuar, sipërfaqen e tokës plot ngjyra dhe erëra të ëndshme, qiellin që dukej i bukur dhe i çuditshëm. Që të mos i shihte dashnori lotët si përlela që shpërthyen papritmas dhe përnjëherë, kush e di përse, nga sytë e saj të bukur dhe që ju derdhën mbi fytyrën si sedef, ajo ktheu kokën mënjanë. Duke bërë sikur nuk pa gjë, dashnori i nguli sytë përdehe. Por ishte një dhuratë e madhe të shihje ata sy si bathra të dehur dhe të mbushur me lot.

Djaloshi i hoqi sytë nga dheu. Duke vështuar shtatin gjithë hieshi të vashës, se si i pa kësaj nën fundin e fustanit këmbët e brishta e të bukura. Një stuhi rrënqethjeje i përshkoi gjithë trupin dhe e vërtiti në vorbullin e mahnitjes. Këmba e saj e vockël, që ishte futur me kujdes dhe me drojtje në mes të manushaqevet, me të vërtetë ishte plot mituri dhe rini, bukuri dhe shije. Therma e saj e hollë dhe e gjatë ishte, pa fjalë, një burim sheqeri i dashurisë. Prandaj duhej që vasha, ndërsa e shikonte me frikë dashnorin e saj, t'i jepte këtij të drejtën që ta puthte atë me buzët e fantazisë. Oh, po pse vallë nuk po mundej ky ta puthte me buzët e vërteta? Lere që kjo s'behej, por atij i duhej madje edhe që ta kthente mënjanë fytyrën dhe të mos ta shikonie fare vashën, sepse ajo kishte kthyer tashti fytyrën nga ai dhe po e vështronte.

Thesarin që me aq lakmi e kish zbuluar syri i dashurisë, e fshehu dhe e zhduku fustani. Do të kish qenë një gjë e ëndshme, sidomos, sikur ai të kish parë kur ajo këputi ndërkohë një degëz ferre që ish pranë dhe që, mbasi i çpoi gishtrinjte, e hodhi tej. Por në këtë çast djali i shkretë kish mbyllur sytë dhe kish dalldisur në botën e të menduarit.

.....

.....

## 23

Ashtu si zogjtë, të cilëvet u zihet fryma duke qëndruar ngjitur me njeri-tjetrin në një degë të vetme dhe që prandaj çajnë me krahët e tyre ajrin dhe fluturojnë duke e lënë degën që të tundet, ashtu ata u ngritën dhe filluan të ecin. Ashtu si trembin gjethet që tunden nga era zogjtë e vegjël brenda në foletë që ndodhen në këto gjethe, ashtu edhe dashuria po trembte dhe po shqetësonte zemrat e të rinjvet, po i frikësonte dhe po i trazonte përbrenda ata.

Zëri i ëmbël që dilte nga era që fshikte barin e gjethet dhe nga takimi me këtë erë të lehtë i krahëvet të mizave në fluturim, i shëmbëllente një hymni të bukur. Shikonin fytyrën e njeri-tjetrit me bishtin e syrit. Por sa herë që u kryeqëzoheshin vështrimet, ata të skuqur kthenin kryet mënjanë për të mos parë njëri-tjetrin.

## 24

U kthyen duke marrë rrugën nga e cila patën ardhur. Duke marrë edhe më shumë zemër, djaloshi i afrohej vashës dhe ngrinte degët e njoma, ose e zinte për krahu në të tatëpjetat, ose e ndihmonte për të hedhur përrenjtë. Herë-herë jetulla e kaltër që lidhte leshrat e bukur të vashës valëvitej nga era dhe cikte buzët e djaloshit. Prandaj takimi me të dashurën i falte atij një gëzim të jashtëzakonshëm dhe një fitore të madhe.

Duke marrë edhe pak më shumë guxim, ai u zhyt në një dëshirë të rrezikshme siç ish ajo që t'i ngulte sytë linjës bojëqielli që mbulonte gjitë e vegjël të vashës. Për hir të vështimit jetëdhënës të dashurisë linja u bë një trup i tejdukshëm. Tashti kraharori i vashës ishte bërë qok ëe shigjetës së dashurisë. Të gjithë shtatin ja përshkoi drithtërima; por, prapë s'kish guxim të fliste.

## 25

U afruan te muri i rrethuar me dredhkëza i shëtitores. Vasha ecte në krahun e djathtë në heshtje të plotë dhe e menduar. Djaloshi mundahej me të gjitha forcat e mendjes së tij që të gjente ndonjë shkak për të hapur bisedën, por, si i mungonte guximi, i mungonte edhe zotësia krijuese. Megjithatë, i shtytur nga një fuqi e jashtëzakonshme nga brenda, ai filloi të fliste. Atë po e ndihmonte

tashti e gjithë natyra. Ngjyra e qiellit dhe rrezet e arta të diellit ja shtonin më tepër zilinë; era e ëndshme që sillte në hundë puhiza nga lulet dhe gjethet ja ledhatonte zemrën; fiskaja rithmike e ujravet që rridhnin aty prapë u jepte mprehtësi veshëve të tij; trupi si billonjë i së dashurës, faqet si trendafille dhe bukuria dhe hieshia e saj e shtynin që të nxirrte në pah ndiesitë e holla të zemrës së tij. Ai e dinte fare mirë se po të mos përfitonte nga çasti që i kish dhuruar tasht i natyra, zemra e tij e brengorsur do të vuante gjithmonë. Se e mira që të sjell fati njëherë nuk të vjen prapë në derë.

Kujdesi që po tregonte natyra për të stolisur tokën, vullneti që po shpenzonte ajo si trimëshë për të ngjallur bimët që i kish cilitur rrebeshi i të ftohtit, kënga e zogjvet, fëshfëritja e gjethevet, fërfëllima e erës, era e dashur e lulevet, bukuria që po sodiste djalo-shi në çdo kënd të natyrës në çdo drudhëz të kësaj, të gjitha këto i zgjuan atij mendimet dhe ndiesitë dhe bënë që t'i dridheshin telat e zemrës.

Duke marrë edhe një herë më tepër guxim nga rrjedhja e fjalëvevet, ai zuri të hynte ca nga ca në të fshehtat e dashurisë. Zëri, lëvizja, fytyra e tij flakë e kuqe i tregonin më mirë se fjalët e bukura e të stolisura ndiesitë dhe mbresat e dashurisë dhe të miqësisë së ngrohtë.



Ndërkohë goditi që ata panë asaj ane një vend shumë të bukur, që nuk mund të përshkruhet me pendë dhe të tregohet me gojë. Ishte një pamje që do të mundej ta kapte vetëm një mendje poeti: e hieshme, e ëmbël, jetëdhënëse, një pamje si parajsa, që të falte filladitje, prehje dhe ngazëllim. Dielli u jepte atyre anëve një shkëlqim që nuk përshkruhet dot. Toka dukej si një pëlhurë e bukur, kurse qielli si një çarçaf i kaltër. Ja, mu te ky vend djaloshi shtrëngoi gishtrinjtë e brishtë të dorës së bukur të së dashurës dhe i puthi ata kaq herë me të gjithë fuqinë që i falte dashuria. Ah, se çfarë çasti i ëmbël!

Që të dy ishin të gëzuar, fytyrëçelur, të kënaqur e plot shend e verë. Duke mjaftuar me aq, vasha hodhi sytë përçark e skuqur nga turpi, kurse dashnori i saj, i turpëruar një-mijëherë më shumë nga vetëvetja se kish kaluar kufirin dhe ishte treguar jo i urtë, i nguli vështrimet e tij, sikur po lypte mëshirë, në sytë magjiplotë të së dashurës, u tret në hieshinë dhe ëmbëlësinë e kësaj, humbi në shijen që i falte ajo nënqeshje. . .

Pas tre muajsh ata u takuan prapë. Vëra po e zbatonte pikë për pikë ligjin e saj dhe po e kreynte si duhej shërbimin.

Vasha ishte shtrirë në një shtrat mbi një çarçaf krejt të bardhë, bërryllat i kish mbë-

shtetur mbi një nënkrese të butë; krahët, që i kish zbuluar gjer në supet, i kish ngritur drejt majës së kokës dhe dora e brishtë dhe e vockël kishte humbur në dallgën e bufkavet të saj.

Këmisha e hollë si tymi prej tyli të bardhë — që u shëmbëllente dallgëve që ngre era e veriut në faqen e detit — të linte t'i shihje asaj trupin si jase mini; por me gjithë këtë, me që ja kish mbuluar të gjithë shtatin si pisha gjer në thembrat e këmbëvet, ja kufizonte pamjen dashnorit duke i lënë zbuluar atij vetëm këmbët e vockëla.

Kur vasha mirrte frymë, bashkë me dallgët e këmishës fryheshin dhe uleshin edhe supet e saj të bardhë si zambaku si dhe kukumet<sup>7</sup> e ergjendëta të asaj shtatjasemineje.

Shtrati ishte vënë në një çip të një dhome të madhe në katin e tretë të një shtëpie të lartë. Në mes ishte një tryezë e rrumbullakët me ca libra sipër, anës ishte vendosur një kanape prej kadifeje të gjelbër, dy kolltukë dhe disa karrige, kurse në murin përkundrajt ishte varur një pasqyrë e madhe.

Dhoma kundërmonte nga lulet që kishte përçark — Nga veriu ishin katër dritare, kurse nga perëndimi dy. Perdet ngjyrë tërndafile

7) Kukume-ja = shishe boje e rrumbullakët.

të dritarevet që ishin nga veriu valëviteshin me poterë të madhe në dhomë.

Kopështi që ndodhej poshtë këtyre dritareve ishte plot me trëndafila të kuq, rozë e të bardhë, me jasemine e lulenishte ishte stolisur me jargavanë, zambakë, karafila, tulipanë, lulekadife, borzilokë dhe me lule të tjera të merme.

Fusha që shtrihej përpara vende-vende ishte e blertë dhe vendevende dukej si pakëz e zverdhur, sikur të ish kështu një fushë shahu. Tej në fund, dukej një varg malesh të larta me maja të rrethura nga re të bardha.

mënjatë dhe me ngjyrat e nojmat e tyre i tërhiqnin njerëzit nga vera e dashurisë dhe i grisnin nga qelqi i miqësisë së dlirtë; ca të përvaajtura dhe njësh me tokën, ca të tjera — kryelarte që s'flisnin me gojë.

Shihej kudo, si hieshia e kopështit, që shpërthente nga toka, si edhe era e ëndshme që vinte nga qielli.

## 3

Sa herë që në rruginat e kopështit shëtinin duke u tundur pallonjtë, u binin përdhe fustanet e gjata të zbukuruara me gurë smeraldi dhe me tela ari. Duke u përqaftuar me njera-tjetrën guguçet lëshonin kujën sikur të kish ndodhur gjë. Rosat dhe patat i kishin lëshuar krahët poshtë dhe rrinin të dëshpëruara dhe të menduara. Një qen i madh i bardhë ishte shtrirë mbi barin e vakët në hien e një plepi të drejtë, kishte nxjerrë gjuhën jashhtë dhe po mirrte frymë me vështirësi. Spurdhjakët ishin strukur nën gjethet e drunjvet dhe dremitnin pa u ndjerë fare, kurse mizat vërtiteshin nëpër dhomë duke zukatur.

Duke mërmëruar shpejt e shpejt me gojën brisk dhe të ëmbël ca fjalë të ngatërruara dhe të pakuptueshme, që kishin të bënin me të fshehtat e natyrës, dallëndyshet hynin në dhomë dhe vinin përqark me nxitim; pastaj mbasi të kishin hedhur përreth një sy prej arkitekti dhe mbasi të kishin sajuar në mendjen e tyre foletë dhe të kishin plotësuar planet, dilnin jashtë; por përnjëherë, mbasi të kishin

parë mirë<sup>8</sup> vendin me syrin e atij njeriu që përgjon, hynin sërish në dhomë dhe fillonin të endeshin përçark.

## 4

Djaloshi kishte ndenjur pranë vashës. Meqë ish mbështetur edhe ky në nënkresën e saj, domosdo që flokët e njerit përziheshin me ata të tjerit. Asnjërit s'ja kish ënda të fliste, por që të dy soditnin në heshtje dhe të shkujdesur pamjen që dukej nga dritarja. Vëmendjen e djaloshit e kish tërhequr një trumcak që po ligjëronte. Qielli mori një ngjyrë të zbetë. Të nxehtit sa vinte e po shtohej më shumë e po bëhej i padurueshëm. I gjithë vendi përçark u bë si furrë, dheu digjej zjarr. Meqë s'fryente fare veri, rrezet e diellit të përvëlonin sytë. Hijet binin mbi siprinën e tokës si nishanë të zinj faqesh. E gjithë natyra kish të rënë në gjumë. Edhe shpenzëvet ju duk më mirë të heshtnin, prandaj u strukën në një kënd.

## 7

E futur në tylin e bardhë vasha flinte krejt e qetë dhe pa u ndjerë fare. Trupi i saj i ngjante një burbuqeje trandafilli brenda në boçën e saj: kraharorin e ergjendë e kish gjysëm të zbuluar, supet i dukeshin më të bardhë se dëbora, qafa e lëmuar si akulli.

8) Mbasi të kishin kontrolluar.

Në fytyrën e saj lexoheshin tiparet dhe vetitë e bukurisë: brishtësisë, thjeshtësisë së zemrës, freskisë, kënaqësisë dhe të lumturisë. Ndërsa flinte, djersa që i dilte në ballë, në faqet, në kraharor edhe në krahët, dukej si margaritarë mbi sedefin, ose si vesa mbi trëndafilin. Gjithandej po shpërndahej era e dashur e kaçes si ajo era që sjell nga trëndafili puhiza që fryn në mëngjes.

Pranë vashës rrinte i qetë dashnori i saj. Të gjithë shikimin e tij ky e kish hedhur në hieshinë dhe ëmbësinë e saj. Duke vështruar bukurinë e saj, ai po mahnitej dhe po e humbiste fare; tashti binte që në këmbë nga të rrahurat e zemrës.

Q'është e vërteta, vasha ishte e bukur sa s'bëhej. Sidomos për dashnorin e saj, domosdo, ajo ishte vasha më e bukur, më e ëndshme, më e ëmbël në botë. Mbulesat e gjata të syvet i mbulonin flakërimet e ëmbla të vështrimevet; megjithatë, nuk ishte vështir të dalloje sytë e saj të mëdhenj që lëviznin me një bukuri të rrallë nën perden e mbulesavet. Qepallat e saj të zeza hidhnin një hije të gjatë në pjesën e poshtme të syvet. Vetullat e saja që të mahnitnin i epnin një stoli të veçantë bukurisë së saj.

Balli i saj që s'donte t'ja dinte erës, ishte edhe më i bardhë se dëbora e grumbulluar në rrëzën e malit. Shikimi i saj rrëronte edhe ato zemra që s'i kishin provuar sa duhet ndiesitë që lind dashuria e bukuria dhe brengat që sjellin këto. Sidomos leshrat ngjyre ari e të bukur, që kishin rënë të shpërndarë në supet

dhe në qafën e saj të bardhë dhe që u shëmbëllenin dallgëvet që bien mbi një gur mermeri që ndodhet në breg të detit, i jepnin bukurisë së saj, një ëmbëlsi të jashtëzakonshme. Faqet i rrënjenin si kadife e kuqe, kurse hunda e saj e brishtë ishte si një vijë e bukur ndarëse e hequr në mes të atyre faqevet.

## 8

Kur qeshte me ato buzët e kuqe, i shikoje në gojën e vockël dy radhë të njëjta perlash që ja kishte ndërtuar me shumë kujdes dora e natyrës. Ishte e bukur, e ëndshme e thjeshtë, vëtijëndritur dhe e butë si manare. Aq sa kish bukurinë, kish edhe zgjuarsinë e mënçurinë, gjykimin dhe mprehtësinë e mendjes.

Sa herë që dashnori hidhte sytë dhe shikonte atë trup të saj in si zambaku, qafën që i shëmbëllente shkumbës së detit, supet e zbuluar dhe të ndritur, të ftohtëz si akulli dhe të bardhë si dëbora, sa herë që sodiste bukurinë e saj dhe dëgjonte fjalët e saj, edhe më tepër i shtohet atij dashuria, dliresia e zemrës dhe miqësia e ngrohtë.

Gjunjtë dhe kërcinjte i dukeshin asaj nën tylin e bardhë si mermer nën një copë akulli. Dy këmbët e vockëla të shtrënguara njëra pranë tjetrës tregonin qartë miturinë dhe moshën e saj të njomë. Me një fjalë, ajo ishte lulja e virgjëreshavet. E bukur sa s'kish më aq e bukur sa thoshje që trupi i saj nuk ishte

veçse shpirt, ëmbëlsi dhe hieshi. Ah, s'gjen dot në botë fjalë për të shprehur e për të përshkruar se ç'është bukuria dhe dashuria!

Tek flinte ashtu e qetë, pa u ndjerë, si reja e bardhë në mes të qiellit të qartë në kohën e mbasdites kur moti është i kthjellët, ajo dukej si një lule jasemini në kopësht nën yjet e qiellit, kurse dashnori nuk ja ndante sytë.

## 9

Djaloshit i ngazëllohej shpirti kur shikonte vashën e brishtë që flinte, e qetë dhe si një manare, prandaj i shtohej më shumë vëmendja. I mbante sytë te goja e saj sikur donte t'i kuptonte të fshehtën e zemrës. Dukeu shtirë sikur nuk e kish kuptuar sa duhet bukurinë dhe ëmbëlsinë e vashës, ai e shikonte këtë me vërejtje dhe me imtësi. I dehur nga gëzimi, tërhiqte dhe hidhte në zemrën e vet shpirtin e pafajshëm të së dashurës që ndodhej në botën e gjumit.

O forcë e shpirtit! ti qëndron sipër një rëzimit, dhe i përket qiellit! Vetëm ti mund të bashkohesh dy zemra! Vetëm ti mund të gjesh rrugën që të çon drejt një lumturie shpirti të dliret e të pafajshëm! ...

## 10

Ndërsa djaloshi ishte duke soditur këtë pamje të endshme dhe ishte zhytur në një mahnitje të thellë, qetësia e vashës u prish



papritur. Mjaftoi një lëvizje e lehtë që t'i prishte asaj gjumin e ëmbël, ashtu si mjafton një puhizë për të shpërndarë tymin. Ishte ende në gjumë, por duke ndryshuar pozicionin gjatë lëvizjes, ju ngrit pjesa e sipërme e fustanit prej tyli të bardhë si dëborë. Kjo që sa të hapje e të mbyllje sytë, por brenda këtij hopi i shëndritën thesarët e fshehtë të kraharorit, që ja lbyrën sytë djaloshit.

Kur djaloshi pa ato burbuqet e bardha të së dashurës, u ngrit dhe u hoq në një çip duke kafshuar buzët e tij të kuqe. Zemra i rrahu me vërtik, fytyra ju bë flakë e kuqe, sytë ju errësuan. Ashtu si shikon i sëmuri pjeshkën ose fikun e bardhë, që mjeku ja ka ndaluar t'i hajë, ashtu dhe ai po shikonte shpirtplasar, me zemër të përvëlur dhe me sy të përbotur këtë dhuratë që po e shihte për herë të parë.

## 11

Mbas kësaj lëvizjeje vasha u zgjua. Ajo u shqetësua kur pa dashnorin që ja kishte ngulur sytë. Tashti dallëndysheja kishte pushuar dhe zogjtë e tjerë po flinin në çerdhet e tyre, nën gjethet e drunjvet. Ashtu zgjuar e pa zgjuar, ajo u ngrit, u mbështetet mbi brrylat dhe filloi të përziejente leshrat e bukur me gishtrinjtë e saj të brishtë. Faqet i kishte të kuqe flakë dhe buzët si trendafili.

Leshrat e shpërndarë, sytë ende të përgjumshëm dhe bukuria e saj e ëmbël bënë që t'i çelej edhe një fish më tepër fytyra të

dashurit të saj dashnor<sup>9</sup>. Mbasi hapi nja dy herë gojën, se s'i kish dalë mirë gjumi, ajo shikoi përçark me bishtin e syrit të përgjumshëm për të parë se ç'kish andej dhe plot naze shtrëngoi duart njëra me tjetrën.

Mbasi vështroi një copë herë shokun e saj besnik me një sy kobndjellës dhe me një nënqeshje të ëmbël, i mbylli sytë që të prehej pakëz. Më në fund, tundi kokën, fshiu leshrat dhe u çua në këmbë.

Duke shëtitur nëpër dhomë, ja mori mendjen fare dashnorit me atë trup të derdhur dhe me atë të ecur aq të ëndëshëm.

## 12

Mbasi shetiti pak nëpër dhomë, zuri të dashurin për dore dhe që të dy dolën jashtë. Duke zbritur nëpër një shkallare të gjatë dolën në korridor dhe prej këtej në kopësht. Vasha vuri dorën e majtë mbi supin e dajhtë të shokut të saj dhe zuri të ecte duke u tundur si pallua me fustanin e gjatë e të bardhë që i binte mbi lulet e kopshtit, gjë që i jepte një hijeshi të veçantë shtatit të saj.

Nga të nxehtit e madh të verës kopështi ishte përzhitur shumë. Nga muret dilte zjarr. Prandaj ata qëndruan në hijen e freskët të një borige si t'ishin

-----  
9) Është për t'u shënuar se për të parën herë djaloshi, i cili gjer këtu është quajtur dashnor, pögërzohet me titullin e dashur (shqipëruesi)

dy boça të këtij druri. Pasqyrimi i rrezeve të diellit u digjte sytë si flakë.

Bashkë me të nxehtit vashën po e mbyste edhe era e jaseminit, e shtogut dhe e lulevet të drunjve të tjerë si edhe era e zambakut, e nanesë, e livandës dhe e pelinit. Ju drobit trupi, i ndryshoi fytyra, sytë iu përgjumën fare, kështu ajo mbeti si e mpirë, e dehur.

## 13

Barishtet në kopësht ishin ende të gjelbëra. Kokrrat e qershive shkëlqenin si margaritarë lart në pemë. Degët e mollëvet, të dardhaves, të pjeshkëvet dhe të ftonjvet i kishin përkulur majat në tokë dhe kokrrat e tyre takonin lulet trungjevet të drunjvet që ta kishin ënda t'i shihje.

Nuk frynte fare erë. As gjethja nuk lëvizte. Të gjithë kafshët dhe këndrat kishin rënë në qetësi. Vetëm burkthi krikëllinte dhe vetëm bleta zhuzhurinte si e ndërkyer duke grabitur mjaltin e pemëvet.

Sjellja prej xanxari e burkthit dhe e bletës ja ngacmoi dejtë vashës më shumë nga erërat e rënda, prandaj, domosdo ajo u mërzit.

## 14

Kishin tre muaj që shikonin njëri-tjetrin duke u skuqur që të dy. Kur shihnin shoku-shokun ashtu të skuqur, skuqeshin edhe më

tepër. Këtë ndjenjë turpi e mbulonin shumë herë psherëtimat që u dilnin nga shpirti. Të rrahurat e zemrave u dëgjoheshin që larg.

Fjala **dashuri** dilte shumë rrallë dhe me një drojtje të jashtëzakonshme nga goja e tyre. Pastaj, kuptimin e kësaj fjale ata nuk e dinin edhe. Sidomos vasha pyeste shokun e saj se ç'do të thoshte kjo fjalë e madhe. Megjithatë, pa e kuptuar ata, dashuria kishte pushtuar dhe mbështjellë zemrat e tyre.

Kur s'e kish pranë dashnorin, vasha nuk dinte as veten e saj ku e kishte. Përmbytej në gjithëfarë mendimesh. Fliste me vete. Më në fund tërhiqej në vetmi e dëshpëruar dhe e brengosur. Por më kot. Vetmia ndofta i dëgjonte fjalët e saj, mundet që edhe i kuptonte ... por nuk përgjigjej. Dhe atëhere vashës i pikëllohej edhe më tepër zemra.

Dhëmbjen që i jepte dashuria e kishte në majë të gjuhës: edhe pse e kish kujtuar kaq herë e kaq herë, ja kish ënda ta kujtonte prapë. Mbasi ta kish përmendur e stërpërmendur më se një herë hulumtonte zemrën e saj se mos gjente ndonjë gjë tjetër për të thënë. Ky hulumtim tinzar ja brengoste më shumë zemrën dhe ja turbullonte më tepër mendjen.

Çfarë u duhej vallë që të ishin më të lumtur? Që të dy ishin të rinj, të bukur sa s'kish më. Po, ashtu ishin. Megjithatë, e ardhmja u qëndronte përpara si diçka e çudishme, si një shtatore trishtuese. Që të dy shikonin me frikë dhe me habi. Por asnjeri s'po guxonte të fliste. Vasha e shkretë shëtiste e menduar në

kopësht në mes të drunjvet e të lulevet. Zinte me dorë lulet e thoshte: „Ah, moj lulez e bukur, një ditë ti do të vyshkesh! Por puna është se kokrrat nuk dalin vetëm se nga lulet ...”. Këto thoshte dhe zhytej për një kohë të gjatë në mendime të thella. Nga të menduarit e vazhdueshëm i lodhej dhe i turbullohej mendja. Të shumtën e herëvet dashuria vyshket dhe humbet si trëndafili; ngandonjëherë ajo i shëmbëllen lulevet të drunjvet përmorë.

## 15

E shkreta vashë që më parë ishte aq e celur dhe e gëzuar, aq e qetë dhe e lumtur, tashti ishte e tronditur, e lodhur, e trishtuar. I digjeshin zjarr ato faqet e bukura.

Fytyrën e dashnorit e kishte gjithmonë në mendje. Zemrën e kish të mbushur me dashurinë e zjarhtë. Por ngandonjëherë nga ata sytë e saj, që ishin për t'u adhuruar, rridhnin lotë të përzier me gjak. Zemra e saj e pafajshme, pa ditur gjë ajo vetë, ja kish zbuluar gjer diku të ardhmen.

## 16

Ndërsa ata ishin duke shëtitur mengadalë dhe pa folur nën krekëzat dhe borigat, në hijen e akasievet ishte shtruar sofrë. Përmes trupavet si vishkuj të plepavet të gjatë dukeshin disa livadhe me faqet e trye dallgë-dall-

gë nga era. Hijet e drunjvet zgjateshin drejt lindjes. Dielli ishte me të perënduar.

Era bënte që të lëviste mësalla e sofrës. Gjethet e pemëvet<sup>10</sup> të freskëta që ishin në sofër i jepnin kësaj pamjen e një lulishteje të vogël. Kokrrat e vishnjevët e të qershivet pasqyroheshin në brokat plot me ujë, kurse në qelqet e bardha plot me verë të kuqe dukej shembëllimi i mollëvet, i dardhavit dhe i kajsivet. Trupat e drunjve nga njëra anë dukeshin të ndritur, kurse nga ana tjetër të errët. Era sa vinte e po bëhej më e vrullshme. Zogjtë të zgjuar nga gjumi po fluturonin tufëtufë. Qielli po bëhej dalëngadalë më i çelur, më i kthjellët. E gjithë natyra, e mërëzitur nga amullia, filloi të bënte tutje<sup>11</sup>.

Me zhdukejn e vapës së madhe, ashtu siç u freskua ajri, u qetësua dhe u fladit pakëz edhe zemra e të rinjvet. Megjithëkëtë, froni i brengës dhe i dëshpërimit qëndronte si një re sipër të rinjvet duke i lënduar ata herë mbas here. Meqë nga vapa e madhe s'kishin uri, ata përtonin të hapnin gojën për të ngrënë.

Vasha vetëm sa për t'u argëtuar futi dorën në shportë dhe e mbushi me qershi. Qershitë e kuqe u jepnin gishtërinjvet dhe thonjvet të saj një bukuri të rrallë. E menduar siç ish, mbasi i mbante një copë herë në buzë kokrat e qershivet, i përtypte me shije, pastaj rrëmbente qelqin dhe gëlltise një

10) E frutavet

hurbë nga uji i kulluar.

Kur era kish sulmuar dhe mundur zhegun, filloi të freskohej dalëngadalë. Filluan të lëviznin gjithashtu edhe drunjtë bashkë me gjethet e tyre. Ua nisën edhe zogjtë çivçëllimavet të tyre. Majat e drunjvet dukeshin si të praruara. Retë e imta që ndodheshin në anën perëndimore të qiellit, të pëshkuara nga rrezet e diellit kishin marrë një ngjyrë shumë të bukur e të ëndshme duke bërë që të lindnin në zemër ndiesi të çuditshme.

Kryeartëza dhe mëllenja lëshonin britma, e para duke u tundur me fustanin e saj laragan dhe duke u hedhur e struktur nga një ferrë në tjetrën me zhgunin e saj të zi. Trumba-trumba dhe me potere të madhe fluturonin krillat.

Zogjtë gjithëfarësh dhe ngjyrat e tyre, lëvizjet dhe zërat e tyre, ngjyra e horizontit, ndryshimi i revet, me një fjalë, e gjithë natyra të tërhiqte vërejtjen tej zakonisht.

Kudo shihje nënqeshje gazmend, miqësi vëllazëri. Vetëm një sqifter i mbështjellë në rroben e tij të murtë, duke hedhur përqark një vështrim të babëzitur e dredharak, po përgatitej t'i ngulte ndonjë shpezi kthetrat e tij mizore. Kjo sjellje e sqifterit i shëmbëllente asaj që shohim te njerëzit keqëbërës.

Nuk zgjati shumë kur dielli duke i lënë lamtumirën botës, filloi të hidhej matanë nëpërmjet dritares së perëndimit. Bimët zunë

11) Bëj tutje = lëviz, dal në kërkim, për punë.

ndnin ndiesi të çudtshme në zemrat e të rinjvet.

## 22

Djaloshi u ngrit nga sofrë. Ashtu si përllumbi i egër, që në ditët e caktuara të dashurisë, i dehur dhe i shushatur nga dëshira e zjarrtë për t' u bashkuar me femrën, i vjen rrotull i rrëmbyer shoqes së tij, por që mbasi të kenë hyrë, që të dy në kopësht, ul kokën duke psherëtitur, ashtu edhe djaloshi ju afrua së dashurës së vet shumë i njerëzishëm, me zemër të çiltër, dhe me një sjellje prej dashnorit dhe, duke e falenderuar dhe me turp, zgjati dorën që ta zinte atë. Por i hutuar nga turpi, dora i ra pa dashur në supet e saj, më të bardhë se dëborë dhe në leshtrat e bukur që i falnin dëfrim syrit; prandaj u turpërua edhe një herë më tepër. Kur pa, nga ana tjetër, se e dashura po e vështronte me sytë e saj të mëdhenj, ai e hoqi dorën e shqetësuar dhe me shpejtësinë e atij njeriu që sapo ka filluar të dashurojë.

## 23

Menjëherë qeshën që të dy nga kjo punë e çuditshme, kjo u dha shkas që të shkëmbenin midis syresh ca fjalë rreth dashurisë. Shija dhe ëmbëlsia e këtij bisedimi i ngazëlloi që të dy.

Duke sjellë ndërmend sërishmi lumturinë dhe rininë, dashurinë dhe miqësinë e ngrohtë



ata e kuptuan se në këtë grimë të ëmbël kohe ata gjëndeshin në gjirin e natyrës që ishte nderuar me një stoli të jashtëzakonshme dhe me erëra të mira; e kuptuan se ishin gjallë dhe të lumtur.

Në zemrat e tyre kishin flakën më të bukur të natyrës. Dashuria kish fituar dhe kish bërë shkrumb e hi çdo gjë tjetër veç vetes së saj. Dashuria e tyre ishte lulja më e bukur, më e brishtë, më e ëndshme, më e merme, më e përsosur e natyrës.

## 24

Ishin ngritur nga sofra dhe po shikonin njëri-tjetrin duke qënë në këmbë. Drita e diellit po ndriçonte malet edhe. Hijet zgjateshin në livadhin e gjerë. Era kish pushuar. Zogjtë po binin në gjumë. Pemët nuk po lëviznin fare. E gjithë natyra kish rënë në qetësi. Nata dhe dita po luftonin me njëra-tjetrën duke ngulur këmbë secila që ta kishte ajo sundimin mbi botën. Kur natyra ishte në këtë gjendje, dy të rinjtë, të zënë dorë për dorë, vështruan me kujdes një copëherë përqark. Muzgu i mbrëmjes i brengosi dhe i ligështoi që të dy, u mbushi sytë me lot.

## 25

Mbasi zotëroi për pak kohë ngjyra e ngrysur e mbrëmjes që mërzi djaloshin dhe të dashurën e tij, pllakosi errësira e natës.

Ca nga yjet xixëllonin si shkëndi, ca vezullo-  
nin me dritë të qartë dhe ca të tjerë duke-  
shin si pikëla të praruara. Me fjalë të tjera,  
qielli, siprina e detit dhe moria e yjeve du-  
keshin si shkëndi elektrike, ose si një breshër  
shëndritës që binte nga një re e kaltër dhe e  
tejdukshme. Sipër yjevet si një lumë i shku-  
mbëzuar dukej Kashta e Kumtërit dhe sipër  
kësaj një ngjyrë si ré.

Çfarë duhej të ishte vallë sipër kësaj  
ngjyre të bruzët? Çfarëdo që të ish, ngjyrë  
më të bukur se ngjyra e qiellit nuk mund  
të ketë. Sidomos natën, kur ka hënë, kjo  
ngjyrë është shumë e ëmbël. Në një kohë si  
kjo valët e syrit përplasen mbi njera-tjetrën,  
humbasin vërtikun e tyre, sidomos brenda  
kësaj ngjyre të bukur, dhe mbeten në rru-  
gë... Më kot, syri i shkretë kërkon fundin e  
kësaj shtjelle që s'ka fund. Më kot rropatet  
të gjejë skajin e kësaj fushe që s'ka të mba-  
ruar!

Kur zogut të plagosur i pritet vërtiku i kra-  
hëvet dhe ai shikon se nuk mundet të flutu-  
rojë në hapësirë, bie përdhe si të ish një hije,  
heq dorë nga fluturimi.

Kur pllakos errësira, livadhi dhe drunjtë  
duken të zes; por këtu kemi një të nxitë me  
shkëlqim që të vret sytë... Malet, drunjtë,  
sukat, honet, shtëpitë marrin një pamje të  
egër dhe të trishtimtë; toka të shtie datën.

Drita e hënës zbardh dhe ndriçon vetëm  
majat e plepavet dhe të qiparisavet. Vendet  
e tjera mbeten të mbuluara në një perde të  
zezë që ta shton më shumë dëshpërimin dhe

që i bën ato të duken sikur janë të përzi-  
shëm.

## 26

Yjet, duke dalë që prapa hijevet të drun-  
jvet të mëdhenj po ngjiteshin lart drejt kul-  
mit të tërthores, një avull i hollë dilte nga  
toka, nga barishtet, nga lulet dhe nga majat  
e ndriçuara nga hëna të drunjvet dhe përha-  
pej përçark. Toka po mirrte një pamje shumë  
të çuditshme. Disa pika dukeshin shumë të  
ndritura, disa vende shumë të errëta.

Vallë nga vinte kjo heshtje, kjo qetësi?  
Dukej se era nuk fërfëllonte nga frika e  
errësirës. Asnjë gjethe s'guxonte të lëvizte.  
Drunjtë qëndronin në vend si të shtangur.  
Vetëm kroi se si po guxonte të mërmërinte.  
Po kush e dëgjonte se? E gjithë bota ishte  
në gjumë. Natyra kishte rënë në qetësi.

Hëna po ngjitej ca nga ca drejt kulmit  
të qiellit. Yjet sa vinte e po shëndritnin më  
shumë. Lulet po shpërndanin gjithandej erën  
e tyre. Që të ngjalleshin bimët dhe të mbje-  
llët, filloi të binte një mënjës e imët.

Vallë ç'janë këto dy hije që duken kur  
këtu, kur në mes të livadhit, kur mbanë py-  
llit? Herë kalojnë përmes hijeve të plepavet  
të giatë, herë shëtisin në errësirë, herë që-  
ndrojnë pa lëvizur te sheshi, nën dritën e  
hënës. Në një kohë kur çdo gjë tjetër e ka  
mbështjellë një qetësi e thellë dhe një tri-  
shtim i çuditshëm, vetëm këto dy hije duken  
të lëvizin.

## 28

Janë ata... Djaloshi kish shtrënguar në krahnoror trupin e bukur të së dashurës së vet. Edhe kjo i kish hedhur atij dorën në sup. Dashnori shikon vetëm fytyrën e shkëlqyer të vashës, kurse ajo vetë i ka hedhur sytë nga qielli. Herë vështron Hënën e Shenjëzat, yjet shëndritës, qiellin, Kashtën e Kumtrit, herë i heq sytë që këtej dhe shikon pyllin, errësirën, dritën e lënës, hijet, vendet e trishta, dhe, duke vështruar me kujdes me bishtin e syrit fytyrën e dashnorit të saj të dashuruar i ngazëllohet shpirti. Duke soditur dritën e syvet të tij që vezullojnë si yje, asaj i çelet edhe më shumë fytyra, i shtohet edhe më tepër zjarri i brendshëm. Edhe dashnorit të saj i bëhet zemra mal kur e sheh të gëzuar të dashurën e vet.

## 29

Aq afër njëri-tjetrit janë ata, sa shumë herë duken si një hije e vetme. Kjo hije lëviz ngadalë, ngadonjëherë ajo ndahet, por përnjëherësh bashkohet sërish. Mund t'i dallosh lehtë tek ecin krah për krah në livadh. Ashtu si retë marrin gjithëfarë formash në qiell, ashtu edhe hija herë bëhet dy, herë bëhet një e vetme, herë duket fare afër, herë pakëz më larg.

Me fjalë shumë të ëmbla në gojë ata, shëtitin pranë e pranë dhe mengadalë në mes të livadhit, në hijet e drunjvet, anës pyllit.

## 30

Vesa binte mbi barin si kokrra perlash. Kish filluar të frynte një fillad i lehtë. Lulet po çelëshin sërishmi dhe po shpërndanin përqark një erë të endeshme. Në këtë grimë kohe që të dy, ishin shumë të gëzuar, të qetë sa s' bëhej më. Sidomos vasha. Sytë e saj të bukur i shëmbëllenin Mërkurit, fytyra Afërditës dhe shtati i brishtë Marsit. Supet e saj të bardhë, të zbukuar dhe të fryrë ndritnin si Hëna; leshtrat i dukeshin si Kashta e Kumtrit.

Djaloshit të varfër i mbetën sytë në bukurinë dhe hijeshinë e saj, në pamjen e ëndshme të saj, në shtatin, në brishtësinë dhe në të ecurit e saj. Duke pasur vasha kryet mbi supin e djathtë të djaloshit dhe dorën e majtë mbi supin e majtë të këtij, ecnin që të dy në mes të lulevet dhe yjevet duke tundur si dy ëngjëj që kishin rënë në dashuri me njeri-tjetrin.

## 31

Ah, moj natë e freskët, natë e qetë, natë e errët! Me të vërtetë ngjyra jote është e zezë, por është shumë e ëndshme shumë e dashur, e qashtë si shpirti i vashavet. Ti na e fashit shpirtin më shumë se gjumi Natë e uruar...

Nga na vjen ti vallë? ose nga ç' vend i lartë na zbret ti? E joshur nga përkëdheljet e ditës, ti i bën naze kësaj. Por përpara fytyrës shkëlqimtare së ditës sytë e ty s' kanë dritë fare. Asnjëherë nuk ju shohim bashkë. Ju e

kini ndarë në mes me njëra-tjetrën faqen e tokës. Ju ndiqni pa u mënjanuar nga rruga gjurmat e njëra-tjetrës, zëvendësoni me radhë e kohë pas kohe njëra-tjetrën. A mos zbret vallë nga qielli, moj natë e bekuar? Qielli ... Ah, moj fjalë e ëmbël! Qielli ... sa je i ndjerë, sa je i vjetër, sa je i fuqishëm, aq je edhe i errët... Ç'mirazh i pashtershëm je moj hije e dashur! Si drita, si terri nga të vijnë. Ti je shpresa e zemrës sonë, ti je i dashuri i shpirtit tonë. Vetëm se, ndofta, ti je i paqenë! ...

Por unë shikoj dhe, ja, shoh përpara këtë kupore të rimitë që na rrethon nga të gjitha anët! Ngado që të hedhim sytë, ajo na del përpara. Edhe kur ngrejmë kokën lart, e shohim atë të nënqeshë kundrejt nesh si të ish diçka që përmban një zotim të amëshuar, të përhershëm, të pavdekshëm, e shohim të qëndrojnë në vend pa lëvizur, pa u tundur. Kjo perde e rimitë që shohim ne, kjo gjithësi, ky Qiell, a hie është, vallë? pjellë e fantazisë dhe e pandehmës?

Vaj, vaj! Në qoftë se kjo kupore e thellë, ky hark i çudishëm, kjo perde mahnitëse dhe gëzimdhënëse, pra, në qoftë se këto nuk janë Qielli, në qoftë se nuk janë rruzullimi, në qoftë se nuk janë gjithësia! ...

Heshtje! ...

Por nuk është koha tashti të merremi me këto gjëra, se nata me dorën e saj të lehtë ka tendosur napën e zezë dhe botën e ka mbuluar trishtimi. Shihni si fshihen të vagëlluar yjet prapa drunjvet. Të duket sikur bota nuk jep shenjë jete. Mendime të trishta pushtojnë

mendjen e atyre që janë zgjuar. Veshi trembet nga zhurma më e vogël, sytë s'guxojnë të shikojnë përqark. Frika merr trup dhe fillon të endet përqark me një ecje të ngadalshme dhe të çuditshme. Ajo del nga hijet, ulet për të kaluar nën degët e shtrembëra, ngrihet prapë, qëndron, fillon të dridhet, bredh me vrap, kërcen, hap gojën për ta trembur të zotin e saj, ajo hyn në gjithëfarë trajtash qesh, qan ...

Majat e ndriçuara nga hëna të gemavet që ndodhen në errësi, kur lëvizin, duken si magjistarë, kurse drizat që janë në dritë duken si xhindë që flasin e kuvendojnë njëri me tjetrin.

Qiparizat dhe hijet e tyre duken si një rrëmet shpirtrash të veshur në të zeza, kurse frushulli i erës — si kujë dhe rënkim i këtij rrëmeti. Plepat me fustanet e tyre bleroshe duken si perri mallagare, zgjatovina<sup>12</sup>, përqeshëse. Drunjte e vetmuar atje larg i merr për gogolë që të kllasin datën.

Fërfëllimi më i dobët i shëmbëllen një fishkëllime të vrullshme, lëvizja më e vogël e drunjvet dhe e hijevet i ngjan një sulmi të përgjithshëm.

Dridhen zemrat. Dëgjon zërin e kukuvajkës dhe thua se djalli ka marrë formën e një plake të gjymtuar, që ka derdhur leshrat e bardhë mbi fytyrën e saj të shëmtuar dhe që vajton me klithmën e saj rrënoqethëse e të

12) Zgjatovinë = njeri me trup të gjatë jashtë masës.

ngjirur për krajatat që i kanë rënë mbi kokë; kurse bufi sjell hijen e një plake rrozgane të llahtarshme që ka ardhur këtu nga një botë trishtuese. Pra, prej këso mendimesh e pandehmash gjithfarësh shqetësohet shpirti, zemra sa vjen fillon të dridhet me shumë, trupi rrënoqethet dhe bëhet ujë nga djersa, ngrin gjaku, kërcëllijnë dhëmbët. Të gjitha sendet çohen në këmbë, marrin gjithfarë formash, rendin, ta bëjnë me shenjë. Mendjen e pushton trishtimi dhe llahtari. Njeriu s'guxon aspak që të luaj nga vendi.

Duke u ndodhur vetëm fill dhe natën në një vend të këtillë, fëmitë, sidomos vajzat, domosdo nuk u shpëtojnë dot gjithë këtyre pandehmave. Po kjo i gjeti në këtë kohë edhe të rinjtë tanë.

## 33

Sa po vinte dhe po freskohej. Heshtja po bëhet më e madhe. Në mes të kësaj heshtjeje të thellë u dëgjua papritur një zë: këndesi po sillte lajmn gazmor se po binte drita. Por, mbasi e kuptoi se ishte vetëm agimi i rremë<sup>13</sup>, ai e mbylli gojën i penduar. Një heshtje e mbuloi sërishmi botën.

I dehur nga era e trëndafililit, mësuesi i muzikës, bilbili, s'duroj dot më dhe, duke kërcyer nga shtrati, filloi të këndonte gjithë gaz të fshehtat e dashurisë. Por që të mos u prishte

-----  
13) Ndriçim i kufizuar që duket ndaj të gdhirë, por që humbet shpejt.



qetësinë atyre që ishin në gjumë, ai e ndërpreu këngën. Sërish u kthye heshtja.

Bilbili ja nisi prapë ligjërimin; kënga e tij zgjoi dashurinë edhe te shpezët e tjerë. Shumë zogj dualën nga foletë e tyre dhe filluan të fluturonin nga dega në degë. Pas pak bilbili i lodhur, pushoi përsëri. Duke shkuar pas këtij, pushuan edhe zogjtë e tjerë.

## 34.

Djaloshi po shëtiste me të dashurën. Drita e hënës dukej së ergjënd. Natyra me gazmend të jashtëzakonshëm, lulet me zell e me stolitë e tyre dhe zogjtë me bujë e me gaz, që të gjithë po prisnin lindjen e diellit. Bimët po ngjalleshin sërishmi dhe po qeshnin gjithë gëzim.

Trëndafili, duke hequr napën e boçës, po i tregonte diellit fytyrën e vet. Bilbili, i dehur dhe duke ja marrë me të qarë, po kallzonte me zërin e tij të ëmbël të fshehtat e natyrës, po bënte që të qeshnin trëndafilat dhe po ngazëllonte dy të rinjtë.

## 35.

Ajri i llagartë i mëngjesit, era e ëndshme e trëndafilin, zëri që të përvëlonte i bilbilit, fytyra e çelur e trëndafilishtës, drita e hënës dhe ngjyra e qiellit e rritnin dhe e shtonin më shumë dashurinë.

Duke qenë vetëm fill, pa njeri, si kryeprindërit tonë të parë<sup>14</sup>, nën kuporen e qiellit, duke nuhatur erërat e ëndshme, duke dëgjuar këngën e ëmbël të zogjvet, që të dy të rinjtë ishin zemërpëhur, të lirë, të qetë në gjirin e natyrës, pa u marrë fare me këtë botë dhe me gjërat e kësaj, me çështjen e zhdukjes dhe të përjetësisë së jetës. Ata ishin të kënaqur vetëm me dashurinë, lëvdoheshin, mburrreshin vetëm me miqësinë e dlirtë të tyre. Duke soditur fytyrën e së dashurës, djaloshi kënaqej me fatin e tij. Vasha, duke parë pranë vetes shokun e saj ishte shumë e lumtur.

## 36

Djaloshi shikonte me kujdes bukurinë dhe shtatin e së dashurës që kishte përbi. Ah, sa e bukur që ish ajo! Pamja, leshrat, shtati dhe shikimi i saj të kujtonin perëndeshën e dashurisë.

Aq të zënë ishin me njeri-tjetrin, sa që shëtitnin pa hedhur fare sytë për qark dhe pa u kujdesur qoftë edhe pak për të dëgjuar se ç'bëhej rrotull sish. As drunjtë e gjatë, as lulet e bukura, as lugjet e bleruara, as çivgëllima e zogjvet, as ndriçimi i hënës, as qielli dhe as yjet nuk mundeshin t'u tërhiqnin vëmendjen. Se të gjitha të mirat e dhuratat e tjera ata ja kishin flijuar dashurisë.

---

14) Adami dhe Eva e Biblës.

Ata kënaqeshin vetëm duke shikuar njeri-tjetrin. Madje as që mund të flisnin dot; nuk jepnin as edhe fjalën, ose të betoheshin për aq e për kaq. Dashuria e tyre ishte një betim që bënte shpirti i tyre. Duke harruar madje se ku ndodheshin dhe çfarë do të bënin, ata kishin humbur që të dy në dashurinë e zjarhtë.

S'pipëtinte ende gjë prej gjëje. S'dëgjohej as zëri i bilbilit. Drunjte, gjethet dhe lulet ishin në gjumë.

Të nxehtit dhe ëndja e ditës së kaluar, çivgëllima e dallëndyshes, ai gjumi i ëmbël i vashës, zgjimi i saj, dashuria e mbrëmjes, shija e asaj darke, më në fund shetitja e tyre gjatë natës, ligjërimi i zogjvet, heshtja e thellë e natyrës, hijet e çuditshme të natës, të gjitha këto po kalonin tashti një nga një në mendjen e të rinjvet.

Ndërsa dritat e mëngjesit po ndriçonin dalëngadalë sipërfaqen e tokës, dy të rinjtë po kuvendonin rrëzë një druri, ku ata kishin qëndruar. Vendi ishte rrethuar me degë e me gjethe si të ish një çerdhe. Megjithatë, po të ish në mes të drunjvet një vesh i mprehtë, nuk do të dëgjonte asgjë tjetër vetëm se shaka të ëmbël, vetëm se fjalë të bukura dhe të fisme. Dhe po të ish aty një sy kureshtar, do t'i shihte ata duke u endur bashkë andej e këtej, duke bërë dashuri dhe duke folur gojagojës si dy pëllumba të bardhë. Aq të ëndshëm, aq të ëmbla ishin këto çaste, sa vlenin sa një jetë e gjatë dhe e lumtur.

## 38


Yjet vështronin duke hapur sytë e tyre të mëdhenj. Hëna e ndritshme shtrihej si e kapitur në shtratin e saj që i shëmbëllente një trupi që rrjedh. Erërat e ëndshme përzi-heshin me flladin e lehtë. E gjithë natyra kishte rënë në heshtje dhe po përgjonte me kujdes. Zogjtë po mirrnin mësim duke ndjekur me vëmendje kuvendimin e të rinjvet, dashurinë e tyre, shakatë e tyre. Kohës zuzare<sup>15</sup> i vinte për të plasur nga zilia dhe resa kur shikonte këtë dashuri të çiltër, të dlirtë, të natyrshme, perëndijore, kur shikonte këtë lumturi dhe këtë fat të ndritur.

Duke shkërbyer<sup>16</sup> ato të puthura aq të ëmbla të atyre dhe duke përhapur kohë pas kohe dhe si me tallje te njeri-tjeri jehonën e këtyre të puthurave, malet nxirrnin në shesh të fshehtat e dashurisë dhe të mallit të zjarrtë.

15) Me kohën zuzare ose të *poshtër* (dehr-i dun) poetët e Lindjes myslimane kuptojnë *fatën* e *keq*, jetën e pamëshirshme që punon kundër dëshirave dhe qëllimevet të larta të njeriut (Shqipëruesi).

16) Shkërbej = imitoj.

VJESHTA



Hëna ndriçonte në anën perëndimore të tërthores. Skaji lindor po mirrte dalëngadalë ngjyrën e trëndafilit. Për njëfarë kohe, si viset e ndriçuara, si edhe ato në hije, po mirrin një ngjyrë krejt të purpurtë. Më në fund, një anë e tërthores erdhi dhe u nxi si mellani, kurse ana tjetër u zbardh si ergjendi. Dita po e shtynte dalëngadale natën. Por errësira kërkonte ta mundëte dritën. Gjatë kësaj përleshjeje, nga toka dilte një tym i trashë që ngjitej përplotë; duke shkuar lart ai bëhej më i lehtë dhe rrethonte majat e drunjvet dhe kojkat e malevet.

Zogjtë nxirrnin kokën nga çerdhet e tyre sikur donin të soditnin këtë pamje dhe vështronin me kërshtëri. Por për t'ja marrë këngës, ose për të fluturuar nuk po guxonin. Vetëm një buf, që ish mbështjellë në zhgunin e tij dhe që kish qëndruar mbi një mur, i heshur dhe si i menduar, u ngrit papritur dhe erdhi një herë përçark në hapësirë.

## 2

Me lindjen e diellit natyra mori një tjetër pamje. Ylli i artë shkëlqente nga ana e lindjes si një gur i madh xhevahiri duke derdhur rreth e rrotull një rrëke drite. Në fillim ai ndriçoi çukat e malevet, pastaj ca nga ca të gjithë siprinën e tokës duke ngazëlluar çdo gjë mbi dhé. Retë po rendnin nga perëndimi. Ishte ftohtësirë<sup>17</sup> e madhe.

## 3

Ndërkohë u hapën flegrat e një dritareje të ndriçuar nga dielli dhe gjithë vendi për-qark llamburiti nga drita. Dora që çeli dritaren u hoq menjëherë dhe kjo mbeti e hapur. Pakëz më vonë u hap një derë e madhe dhe duallën dy vetë, një burrë e një grua, të rinj, të pashëm, të brishtë, me buzën në gaz, të çelur, fytyrëllagartë, me duart të futura në dorashka. Duke i hedhur krahun njëri-tjetrit, ata filluan të ecnin mengadalë dhe me hap të matur. Flladi i lehtë i erës bënte që t'u valëviteshin leshrat në ajër. Ishin me rrobat e dimrit. U drejtuan nga kopështi që ndodhej përpara shtëpisë. Kopështi kishte ndryshuar krejt që nga dita e fundme që e kishin parë ata. Plepat e gjatë pothuaj ishin zhveshur fare, ato pak gjethe krejt të zverdhura, që dukeshin aty-këtu nëpër degët, po

17) Ftotësirë = fresk.



dridheshin nga era. Drunjtë që në pranverë dhe verë nuk të linin të shikoje matanë, tashti, me rënjen e gjethevet, kishin mbetur si skelete, kështu që dukeshin lehtë sukat që ishin përpara. Lisat, rrepat, sheligjet, mollët, qershitë dhe drunjtë e tjerë, duke u rënë ca nga ca gjethet, kishin mbetur lakuriq. Vetëm qiparisi kishte mbetur ashtu si kish qenë. Me një fjalë i gjithë mjedisi rreth e përqark ishte shndërruar dhe bërë si një pamje<sup>18</sup> teatri.

Çdo dru ish larguar sikur të kish qenë mërzitur nga fqinjësia e atyre, gjelbërimi kish fluturuar nuk e di se ku dhe vendin e tij e kish zënë ngjyra verdhoshe. Lulishtja i shëmbëllente fytyrës së një njeriu që ka qenë me ethe.

Era që frynte tashti nuk ishte as ai filladi i lehtë i pranverës, as ai veriu i verës; ajo ishte një erë krejt tjetër. Ajo s'kishte as erën e ëndshme që sillte në fejet e hundës në kohën e pranverës, as edhe freskinë që i jepte trupit në verë. Përkundrazi, ajo ishte e ngarkuar me një erë, marrë nga barishtet e thata që nuk e duronte dot hunda; veç kësaj, në vend të freskisë, ajo kishte fituar tashti të ftohtit.

Veshulët me rrush të bardhë e të zi, kokrrat, si korale të thanës, mollët, dardhat dhe ftonjtë kishin humbur pa lënë asnjë shenjë dhe gjethet e drunjvet të këtyre ishin arra-

---

18) skenë

tisur dhe bërë si mos më keq. Frynte era, dridheshin drunjtë dhe nga kjo dredhje binin përdhé gjethet, pa i qëndruar dot erës. Ca lule pa erë që kishin nxjerrë kryet aty-këtu, lajmëronin se kish ardhur vjeshta. Vetëm limonat e portokajtë me gjethet e kokrrat e tyre lëshonin erë dhe i jepnin stoli vendit rreth e përqark.

Mëgjithatë, shumë bimë të shëndosha, si mbeturina të verës, shkëlqenin si smeraldi në mes të barit të zverdhur, në mes të gjethëve të vyshkura. Po rronin ende edhe shumë lule të fshehura nga sytë e stinës.

Veç kësaj, meqë vjeshta është një stinë në mes të verës dhe të dimrit dhe meqë në këtë kohë nuk është as nxehtë, as ftohtë, hijeshia dhe pamja e ëndshme e saj hahet, gjer diku, me madhështinë e pranverës.

Të ngazëlluar nga ajo ditë e bukur, nga ai mëngjes i ëndshëm, nga ai diell i ngrohtë dhe nga ai ajër i freskët, për të parë pamjen që kishte marrë vendi i shëtitjes me hyrjen e vjeshtës, për të njohur tiparet e stinës dhe për të dëgjuar hymnet që po i këndonin zogjtë kësaj stine, dy të rinjtë po shetitnin bashkë duke kuvenduar me ëmbëlsi dhe duke shkëmbyer fjalë dashurie. Si pa të keq dhe si ndonjë shok fluturonte pranë tyre dallëndyshja dhe u uronte dashurinë.

Në të vërtetë, moti të kujtonte dimrin. Nga era e ftohtë faqet e tyre ishin bërë akull të ftohtë dhe kishin marrë ngjyrën e trëndafilut. Por, naneja, karafili, lulja e natës, bathra dhe të tjera lule u kujtonin po në këtë

kohë edhe ditëtë e pranverës. Era e ftohtë, domosdo, i shtërngonte që të ecnin. Si u sullën një copë herë përpara shtëpisë, ata qëndruan dhe biseduan se nga duhej të shkonin. Mbasi morën vendim, shkëmbyen ca fjalë me buzën në gaz dhe u vunë në ecje. Kur... përnjëherësh ata vrapuan drejt një druri të madh, që ish përpara shtëpisë dhe që kish përkulur degët mbi murin. Përpara syvet të vashës, në mes të gjethevet të drurit ishte një kokër pjeshkë e madhe gjysëm e zbuluar si kraharori i vashavet. Meqë kjo punë ishte e rrallë në një stinë të këtillë, domosdo që tërhoqi vëmendjen e të rinjvet dhe i bëri ata të shpejtonin hapat.

Ndërsa vasha vraponte si thëllëzë mbi majat e gishtrinjvet duke mbajtur të ngrihur lart fustanin me të dyja duart, u shëmbëllente engjëjvet me fletë. Prapa asaj bariste edhe dashnori, por të ecurit e këtij nuk ishte edhe aq i ëndshëm. Më në fund, vasha arriti më përpara, këputi pjeshkën dhe e kafshoi me të shpejtë, pastaj, duke shikuar me dhëmbët e radhitur si perla në gojezën e saj të vockël pjeshkën e kuqe e të madhe që mezi kishte mundur të ja zinte dora e brishtë dhe ndërsa qeshte plot dashuri përpara dashnorit të saj, ajo dukej e hijshme dhe e bukur sa s'kishte. Hëngri gjysmën e pjeshës dhe gjysmën tjetër ja dha shokut të saj. I gëzuar sa s'bëhej për këtë të mirë të shtrenjtë dhe duke falënderuar vashën, djaloshi e pranoi dhuratën që i fali ajo. Ah, ajo pjeshkë ishte pemë e një bote të shenjtë.

Ata hulumtuan me kujdes dhe me radhë drunjte se mos gjenin ndonjë pjeshkë tjetër që mund të kish shpëtuar e fshehur në mes të gjethevet. Ata kërkonin me dëshirë të madhe e me lakmi, me zell, me vëmendje dhe duke u ngutur sikur do të gjenin një thesar të madh. Dhe me të vërtetë, një punë e këtillë s'kish të çmuar në atë kohë. Puna e të kërkuarit i argëtonte që të dy. Dëshira e secilit për të gjetur ai vetë pjeshkën ua shtonte më tepër zellin. Por ç'e do, mundimi i tyre shkoi kot. Gjethet e thata të pjeshkëvet s'kishin gjë prej gjëje.

Ata leshrat e bukur të vashës dukeshin si majat e larta të shëndritura nga rrezet e diellit.

Ngjyrat e bukur e mollëvet u shëmbëlente faqevet të vashës së brishtë. Dardhat që verdhonin në mes gjethesh të kujtonin gjithë e fortë të kraharorit të saj, që dukej si ergjënd nën tantellat e verdha. Trupi i saj i mbështjellë në rrobat i ngjante rrushit të bardhë kokërr-madh të mbuluar me gjethet e pjergullës. Gjaku i manaferrave të zes nën napën e blertë ishte i ëmbël si buzët e vashës.

Atyre u ngazëllohej shpirti kur shikonin drunjte e ngarkuar me pemë të kësaj stine. Por menjëherë pastaj u lindëte një mendim i çuditshëm: sepse drunjte në gjuhën e tyre të heshtur u thoshin: „Ne e çuam në

vend zotimin tonë, lulet tona nuk dolën gënjeshtare”.

Ky mendim ua turbulloi që të dyve mendjen dhe i bëri të zhyteshin të vrerosur në heshtje të thellë. Të shumtën e herëvet të vërtetën e kësaj jete të përkohshme shpirti i njeriut e zbulon asoherë kur mbaron lumturia, prandaj atë e pushton brenga dhe trishtimi. Pemët, pamja që kish marrë tashti kopështi dhe gjethet e thara tregonin me gjuhën e tyre të heshtur se e përpjeta kishte patjetër të tatëpjetën.

Që të dy e kuptuan se tërë ajo lumturi ishte më të mbaruar tashmë dhe tërë ajo dashuri që kishin ata ishte e përkohshme, prandaj edhe dukej aq e ëmbël.

## 7

Ja, këto mendime i bënë ata të dy të binin në heshtje të thellë dhe të mbyteshin në pellgun e brengës e të dhembjes. Vesa që kish rënë me të tepërt mbi pemët e arrira, mbi gjethet e vyshkura dhe mbi degët e xhveshura pikonte mbi ata dhe u lagte supet dhe leshrat. Prandaj mbërdhinin shumë dhe u dridheshin buzët. Ndonëse ecenin, në çdo çap që hidhnin ata shikonin se një gjethe e thatë ndahej nga degët dhe binte mbi tokën e njomur. Meqë ishin të mbytur në mendime, një fërfëllim i këtillë i gjethevet i trembte. Ecnin pa shkëmbyer asnjë fjalë me njëri-tjetrin.

## 8

Megjithatë, ende ishin shumë të lumtur. E donin njëri-tjetrin. Në zemrat e tyre nuk ishin shlyer aspak gjurmat e dashurisë. Ata silleshin gjithmonë me dashuri, me fisnikëri, me çiltëri e dliresi shpirti ndaj shoku-shokut. Me një shikim të ëmbël ata soditnin pa folur bukurinë e njeri-tjetrit. Shetitnin krah për krah dhe pranë e pranë. Vetëm kur donin të kalonin kohën duke përfytyruar njëri-tjetrin, ndaheshin duke ecur secili mënjanë ose duke u hequr në hijen e ndonjë druri. Por prapë bashkoheshin. Pas ndarjes së përkohshme ata takoheshin me shumë mall dhe fillonin ta donin njeri-tjetrin me një zjarr edhe më të madh.

## 9

Mbasi dolën bashkë nga kopështi, duke kaluar nëpër një shesh të gjerë ata morën rrugën për në pyll. Por në rrethinën e qytetit nuk gjeje tashti stolinë dhe ëndjen e pranverës. Nuk dëgjohej më zëri i qyqes dhe zëri që të përvëlonte i bilbilit. Sa për zogjtë e tjerë, edhe pse pkëta ligjëronin herë pas here, kënga e tyre s'kishte farë ëmbëlsi dhe s'mban-te erë dashurie. Për më tepër ata të shkretët qanin nga brenda dhe nga dhëmbja që ndjenin në shpirt me afrimin e dimrit.

Pamja mahnitëse e majave të pyllit të rrethuara nga harmoçë sterrë të zes, të gjatë dhe të dendur, forma dhe buçima trishtuese e

lumenjvet të llahatarshëm e të shkumbëzuar që rrëshqitnin me zhaurimë të madhe nëpër shtretërit e tyre të thellë duke u përplasur nëpër gumat, vërshëllima e madhe e erës së furishme, të gjitha këto tërhiqnin shkimin dhe vëmendjen e të dy dashnorëvet. Që lart nga krepit ku ishin ata, hapnin sytë dhe pa lëvizur hidhnin përçark njerin pas tjetrit shikimet e tyre, shikime ku ishin përzier bashkë brenga dhe malli, shqetësimi dhe fashitja, habia dhe ngazëllimi, çudia dhe gufimi i brendshëm.

## 10

Mbasi qëndruan një copë herë kështu të mahnitur, djaloshi u hodh e tha papritur: „Ja, një mjet i mirë për t'u argëtuar, xhevahiri im: eja të mbledhim lajthi!“. Këtë grishje vështa e pranoi me gjithë zemër. Hynë, pra që të dy për të mbledhur lajthi. Me atë sedër që është e vetësishme për moshën e re, secili mundohej të mblidhte më shumë nga tjetri. Duke rënë kështu pas lajthivet, ca nga ca ata u larguan nga njëri-tjetri; megjithatë, për një farë kohe ata ja dëgjonin këmbët shoku-shokut. Por si u larguan edhe cazë, posa që vasha nuk mundëte t'i dëgjonte më të dashurit as zërin, as zhurmën e këmbëvevet, u dëshpërua sa s'bëhej dhe filloi të dridhej nga frika. Çdo degë i dukej si një armik; prandaj shikonte me radhë herë prapa, herë anash. Megjithatë, duke i dhënë zemër vetes, ajo filloi të zvarritej si karçine pas gëmushavet të laj-

thivet duke mbledhur lajthi me atë dorën e saj të brishtë. Sa për djaloshin, ky, për t'u çlodhur, ishte shtrirë në hijen e një qiparisi të madh dhe për të parën herë në jetën e vet po provonte dhëmbjen dhe mërzitjen që i jep njeriut skuta e vetmisë.

## 11

Mbas pak ata gjetën njeri-tjetrin. I kish-te marë mali shumë. Secili filloi të zgjidhte lajthitë më të mira, që kishte mbledhur vetë dhe t'ja jepte shokut me shumë fisnikëri. Ndërkohë era ishte bërë më e vrullshme, ajo po i dëbonte retë dhe po ngrite përpjetë gjethet e zverdhura që ishin rrëzuar përdhe, duke i përndarë këto pastaj gjithandej. Një rrapëllimë tej zakonisht shurdhuese u dëgjua të dilte nga drunjtë, gërxhet, rrëzomat dhe lugjet e thella. Era edhe të rinjtë po i mër-ziste, edhe botën po e bënte lesh e li. Ky ndryshim kështu i motit i pikëlloi që të dy dash-norët. Këtyre u dukej se gjethet e thata që po fluturonin në hapësirë do t'u rrëmbenin me pahir dhe do t'u përulanin ndiesitë e fisme e të holla që ata kishin në zemër.

Një dorë e fshehtë tendosi pa u vënë re një napë të zezë mbi fytyrën jetëdhënëse të diellit dhe mbi faqen e llagartë të qiellit. Tër-thorja u nxi më shumë e më shumë, ndryshoi moti, filloi të gjëmonte qielli dhe të flakëron-te vetëtima.

Duke parë këto ndryshime, vasha u mbështuall me shallin e saj dhe, si vështroi me



frikë dhe e shqetësuar njëherë përçark, i tha shokut: „Eja të shkojmë i dashuri im! J'arriti shiu!” dhe filloi të ecte me link. Pas asaj u nis edhe dashnori.

## 12

Ndërsa vasha ecte me nxitim, dashnori e shikonte me vëmendje. Vështronte me kujdes bukurinë dhe shtatin e saj, hieshinë dhe sjelljen e saj të fisme, lëvizjet dhe të ecurit e saj të ëndshëm. E dashura i dukej si një vidë e shkathët që po fluturonte në ajër. Kur ajo rendëte me link, fundi i saj i zi, i prerë pas trupit, bënte që ti dukej forma e mesit dhe e shtatit.

Meqenëse koha u ftoh keq dhe zuri të binte shi, ata filluan të nxitonin shumë. Mirrin frymë me vështirësi. Nga buzët e kuqe u dilte një avull i dendur. Faqet u ishin bërë akull nga era, kuqonin si taftaja. U binin lotë nga të ftohtit. Ecnin dhe kënaqeshin që të dy duke parë të gjitha këto që po ngjishnin. Por nga që rendënin me nxitim, nuk e shihnin dot njëri-tjetrin.

## 13

— Ç'mot i bukur ky! — thoshin ata. Se ishte hera e parë që po e shihnin si duhej natyrën, ishte hera e parë që po e ndjenin atë, hera e parë që po e kuptonin. Dhe në të vërtetë, ishte për t'u soditur kjo kohë: qielli ishte krejt i mvrejtur, era fryente me rrëmbim, dru

njtë tundeshin me zhaurimë. Kish nisur të bin-te një sh. i i lehtë. Gjethet frushullonin. Faqja e tokës po përtërihej nga shiu. Lulet që kishin mbetur edhe, përndanin një erë të ëndshme.

Duke ecur gjatë rrugës që ishte shtruar me gjethet e rrëzuara nga era, atyre u binin përsipër gjethet që sapo kishin rënë nga degët.<sup>19</sup>

— Sa bukur është të jetosh, — tha djalo-shi duke i rrahur zemra.

— Ah, sa e ëmbël është të dashurosh, — ju përgjegj vasha.

## 14

Djaloshi ishte çapkën i lirë, i lumtur, i gëzuar, zemërçpenguar, i sjellshëm, vështri-mëmbël, syshkëndi; ishte i thjeshtë dhe sjell-ja e tij përputhej me moshën që kishte. E dashura e tij shikonte bukurinë dhe hijeshinë e tij me bishtin e atyre syve të bukur nën qe-pallat e gjata si të ishte një përgjuese tinzare dhe i bëhej mendja çapraz. Por edhe djalo-shi, që e kuptonte këtë përgjim tinzar, e hidh-te shikimin në anën tjetër, i trupëruar. Kur hidhnin papritmas vështirimet mbi njëri-tjet-rin, vasha i ulte sytë ngadalë si një engjëll dhe i ngulte në tokë, ose qeshte duke e shi-kuar djaloshin me dashuri. Asohere dashno-ri, duke e përçafuar, i fërkonte faqet e buku-

19) Në tekstin e origjinalit kemi një lojë fjalësh, që s'mund të ruhet në përkthim (Shqipëruesi)

ra, ose e puthe në ballë. Vasha nuk skuqej tashti, e puthura që i jepte shoku ishte, si të tuash, e puthura e një vëllai.

## 15

Koha filloi të hapej pak. Me të parë që ndryshoi moti, ata u mënjanuan pakëz nga rruga dhe filluan të baritnin aty-këtu; si u lodhën, qëndruan dhe zunë të kuvendonin me fjalë të ëmbla. Megjithatë, që të dy dukeshin të shqetësuar sikur t'u kish humbur diçka që s'kishin mundur ta gjenin sado që kishin kërkuar shumë. Kjo ditë që po ndryshonte prorë u duk muaj të dyve.

Retë po ndryshonin vazhdimisht ngjyrën e tyre: herë bëheshin të kaltra, herë të bardha si shkumba e detit, herë krejt të murrta dhe herë të zeza, duke zënë kështu diellin. Me t'u fshehur dielli, Toka binte në zi, të rinjvet u këputej koka dhe u bëhej vrerë shpirti sikur të kishin humbur çdo gjë që kishin pasur. Duke përfituar nga zhdukja e diellit, të ftohtit po sulmonte drejt nga Toka.

Bukuria që është më të mbaruar nuk ndryshon në dukje nga bukuria që është duke filluar ashtu si nuk ndryshon edhe dashuria që sapo zë fill nga dashuria që është më të shterruar e sipër. Por bukuria dhe dashuria që janë më të mbaruar janë më tërheqëse, më të reja ... Megjithatë, nuk e di përse bukuria dhe dashuria që janë më të perënduar janë të mbështjella me dëshpërim dhe me brengë.

E puthura e lamtumirës është më e ëmbël dhe më e shijshme nga e puthura e takimit, vetëm se ta brengos dhe ta pikëllon shpirtin. Neve na duket më e dashur manushaqja e fundit të pranverës se sa ajo e fillimit të pranverës; e duam atë më shumë, se nuk na zotoni asgjë, e dimë se së shpejti ajo do të humbasë nga faqja e dheut.

## 16

Përnjëherësh që të dy ngritën kokën nga vorbulli i dëshpërimit dhe i mendimit të thellë ku ishin fundosur. Nënqeshjet e tyre të ëndshme u shëndritën ballin, ashtu si shëndritë dielli retë e imta. Duke shtërnguar duart me dashuri, ata i dhanë zemër njeri-tjetrit me fjalë që shkëmbejnë dashnorët midis syresh. Vasha vuri kokën në kraharorin e djaloshtit dhe i hodhi këtij duart në qafë si t'ishte një fëmi e pafajshme. Asohere dashnori, duke bërë buzën më gaz, i puthi asaj sytë e bukur dhe ballin e ndritur. Sadoqë e puthura e tij nuk ishte e ftohtë, prapë s'e kishte atë nxehësi dhe afsh të dikurshëm, sadoqë bukuria dhe vesku i vashës, hijeshia dhe pamja e ëndshme e saj, njomështia dhe brihtësia e saj, ëmbëlsia dhe kripa e saj, lëvizjet e matura dhe të ecurit e saj të bukur, pastërtia e shpirtit dhe dliresia e zemrës së saj ishin të plota sa asnjëherë.

## 17

Era po qetësohej ca nga ca. Ré laroshe mbështuallën si perde tokën. Natyra dukej shumë e dëshpëruar dhe si e zëmëruar. Dëshpërimi dhe brenga kishte mbështjellë si ré edhe zemrën e djaloshit, edhe atë të së dashurës së tij.

Ata kishin humbur pa ndonjë shkak gëzimin e parë. Ishin zhytur në ca mendime që po i trishtonin që të dy. Po bëheshin përherë e më të brengosur, më të drobitur, më të shqetësuar, më të zymtë. Kjo gjendje e çuditshme, që po ua kthente gëzimin dhe lumturinë në dëshpërim dhe në brengë, ishte lulja e fundit e dashurisë dhe e miqësisë së ngrohtë.

## 18

Era filloi sërishmi të frynte furishëm duke përçarë çdo gjë rretheqark. Gjethet fluturonin në ajër. Retë u bënë më të dendura e më të dendura, u nxinë më shumë e më shumë. Të rinjtë e varfër po shikonin me dhëmbje se natyra po ua mirrrt e prapë dhuratën që u dha, se ajo po ndryshonte, po rrëndonte dhe po zhdukte çdo gjë, se jeta s'kishte besë dhe se lumturia nuk ishte e përhershme.

U dukej sikur kishin një gjë plmubi të rëndë në kraharor, në ndjenjat, në shpirt dhe në trutë. Kudo vihej re një ndryshim i madh.

vegla bujqësore si qerre, zgjedha e tjera. Zhurma e një mulliri që ndodhej mbanë lumit i jepte shkas zhytjes së mëtejshme në mejtime dhe lindjes në tru të gjithfarë gjera-ve të paqena.

Ca dallandyshe të mbledhura rreth qiparisash kuvendonin me potere, pleqëronin punën e udhëtimit që do të mirrnin dhe bënë provat e duhura. Vasha e djaloshi i shikonin këta zogj me mallëngjim dhe me sy të llah-tarshëm. Nga shikimet e tyre kuptohej se donin të thoshin këto fjalë: „Ah, o zogj të bukur, edhe ju po na lini?!”. Po e shihnin se toka dhe qielli po e humbisnin vazhdimisht veskun e tyre.

Ndryshimi i natyrës po ua zhdukte shpresat pa lënë shenjë. Të rinjtë po e shikonin vdirjen e fushës me atë sy që shikon fëmia i përzënë tanë që i ka dhënë atij dukën.<sup>20</sup>

## 22

Retë e ndryshuan sërish ngjyrën; duke mbështjellë ajrin rreth e përçark si një tym i zi, ato e mbuluan krejt tërthoren. Mbas kaq gjëmimesh, që filluan përnjëherësh e mbas kaq vetëtimash e rrufesh të njëpasnjëshme, nisi të binte një shi i rrëmbyeshëm.

Që të dy të rinjtë vrapuan sa mundën drejt një kasolleje që dukej aty afër dhe hynë bre-

20) i dhashë dukën = e dëbova

nda në atë. Të mbështetur mbi supat e njeri-tjetrit ata soditnin shiun e rrëmbyeshëm, fushën dhe përrenjtë e sajuar nga ujërat.

## 23

Pas pak shiu u bë më i stuhishëm, era i shkatërroi drunjtë dhe i bëri kashtë e kokrra gjethet. Përrenjtë u bënë më të rrëmbyeshëm, gjëmimet u dendësuan. Re të zeza mbuluan të gjithë dhenë, qielli s'po dukej më. Fusha mori pamjen e detit. Të trembur nga shtërngata dhe duke u dridhur nga të ftohtit, fëmijët e varfër qaheshin nga këto që po ngjishnin dhe thoshnin: „Çfarë shiu i rrëmbyeshëm! Ç'erë e fortë! Ç'përrenj! Sa ftohtë! Ç'rrebesh! Ç'kijamet!”

Pas një copë herë shiu u pre, retë u davaritën, era u qetësua, gjëmimet pushuan. Ndonëse rrëketë po rridhnin edhe, vrulli dhe zharima e tyre u pakësua. Qielli u çel sërish. Por sytë e fëmijëve të shkretë, megjithatë, ishin plot me lotë. Reja e brëngës, që kishte mbështjellë zemrat e tyre, nuk u shporr dot. Dëshpërimi dukej si hie në ballin e tyre. Ata humbën lulet më të bukura të rinisë, të fatit, të bukurisë dhe të hijeshisë, të haresë dhe të dëfrimit, të dashurisë dhe të miqësisë së ngrohtë; humbën shijen e ëmbël të ditëve të bukura të takimevet me njeri-tjetrin. Jetës pa dashuri s'i kishte mbretur asnjë shije. Se zemra e mësuar të rrojë me dashuri, kur e humbet këtë, i lan duart nga çdo gëzim, mbetet shkret dhe pa shpresë, .....

Dielli ndodhej në anën perëndimore të tërthores së ngarkuar me ré. Ai dukej si një copë e madhe ari në mes të revet. Hijet po zgjateshin nga ana e lindjes. Fëmijët donin të ktheheshin në shtëpi po nuk mund të kalohej dot nga pylli. Rruginat e ngushta ishin shkatërruar krejt dhe i gjithë vendi ishte bërë baltë e gjallë. Përrenjtë nuk hidheshin dot édhe. Ujë të vazhonte të zbrazej nga çdo anë. Nga drunjat binin pika të ftohta si akulli. Në mes të këtyre vështirësive ata panë një tym që dilte nga pylli. Ishte tymi i zjarrit që kishin ndezur me karthje e me bar të thatë barinj të dhe druvarët për t'u ngrohur. Nga era tymi u përhap nëpër të gjithë pyllin. Ta kish ënda erën e këtij tymi në gjithë atë lagështi. Pak më vonë, andej nga dilte tymi u duk një flakë e madhe. Të shkretët i kthyen nga zjarri duart e ngrira që të ngroheshin nga larg. U dridhej i tërë trupi nga të ftohtit, leshrat u ishin bërë qull nga shiu. Zëri i një borie që i ra papritur në pyll në mes të asaj heshtje të madhe një gjahtar, që donte të mblidhte shokët e tij, e shtoi edhe një herë më tepër llahtarinë. Dy të rinjtë menduan se ishte shumë vonë. Vendi ku do të shkonin iu dukej shumë larg. Shumë pengesa shihnin për t'u kthyer. Nga frika kujtonin se koha po kalonte shumë shpejt dhe se po afrohej mbrëmja. Kishin frikë nga errësira e natës, nga vetmia e llahtarshme, nga pylli, nga shkëmbinj të, nga bishat, nga lumenjtë. Pas pak boria



pushoi. U shua edhe zjarri. Heshtja dhe llah-tari u shtuan edhe njëmijë herë më tepër. Plot frikë e dashuri shikuan asohere në sy njeri-tjetrin. Në buzët e tyre të ftohta spikati një nënqeshje e ëmbël. Engjelli i dashurisë erdhi të shihte zemrat e tyre për të fundit herë. Të zënë dorë për dorë ata filluan të ecnin.

## 25

Në të kthyer nga rrethina e qytetit, u ulën për të lundit herë në lëndinën e shëtitjes afër njeri-tjetrit si një çift pëllumbash, si dy qiparise. Fishkëllima e erës dëgjohej si bori. Shkalla e të ftohtit të ajrit tregonte se dimri po afrohej. E gjora vashë kishte ngrirë nga të ftohtit; duart dhe faqet i kishte akull. U mbështuall me shallin dhe duke u afruar edhe ca, shikoi dashnorin në fytyrë me ata sytë e ëmbël. Meqë e pa atë shumë të brengosur, e zuri në dorë me dhëmshuri dhe i hodhi sërish një vështrim edhe më të thellë, edhe më të mallëngjyeshëm. Pastaj përnjëherësh ra në prehërin e tij, i hodhi duart në qafë dhe me një shikim qiellor, me një sjellje engjëllore dhe me një gjuhë, që ja bëri copë-copë zemrën dashnorit, i tha: „Do të duhemi gjithmonë! përjetë! Apo jo?”.

Duke i ledhatuar asaj leshrat e bukur, ballin e bardhë dhe faqet e kuqe, dashnori i shprehu besnikërinë e vëllazërinë dhe me një shikim shumë të çuditshëm, që bashkë me dëshpërimin kishte me vete edhe shpresën,


kundroi për një kohë të gjatë sytë e bukur të saj.

Të shkretët fëmi! Kërkonin t'i mbanin me çiltërinë e zemrës dhe me pahir lumturinë dhe gëzimin që u kish sjellë dashuria. Nuk donin ta leshonin. Por më kot. Natyra vazhonte t'u mirrte nga zemra dashurinë e ngrohtë dhe, për t'u argëtuar, po ua griste atë si të ish një copë letër pa vlerë. Bashkë me dashurinë po fluturonte edhe lumturia që ishte e lidhur me të.

Kur panë se u kish hyrë në mes zana e ndarjes dhe e largimit, që të dy përnjëherësh derdhen lotë kalivar. Tronditja dhe ngashërimi ua kyçi gojën, ju zu fryma, fytyra ju ndryshua. Shikonin njëri-tjetrin si të mpirë dhe si pa mend, ashtu si ata që janë duke dhënë shpirt.

— Ah, ndarje e përjetshme! Largim për sa të jetë bota! Lamtumirë e fundme! Se ç'gjëmë e madhe! — thoshin ata duke qarë me dënesë ...

*DIMRI*



Dimri kish filluar të bënte punën e tij. Tokën e kish mbuluar dëborë. Malet, fushat, drunjtë, livadhet, kodrat, rrugët, e gjithë bota ishte bërë një gjë krejt e bardhë. Kronjtë, lumenjtë, përrenjtë kishin ngrirë krejt. Toka kishte marrë pamjen e një veje.

Re të murrta më të zeza qëndronin si një perde e trashë mbi dëborën. Era e ftohtë dhe e furishme e ngrinte lart si niseshte dëborën, duke u sajuar kështu një tym i bardhë.

Tërthorja nuk dukej fare. Fqollat e dëborës fluturonin si të ishin pëllumba të bardhë; herë binin në tokë mengadale dhe herë me vërtik si plumba. Ajri ishte shumë i ftohtë dhe era si e ndërkeyr. Bota kishte mbetur shkretë dhe pa pikë bukurie. Rruzulli i Tokës ishte mbështjellë me savan, kurse qielli kishte hedhur përsipër një perde të zezë. Natyra vajtonte.

Çdo gjë e kish pushtuar brenga dhe dëshpërimi.

Vallë kush e ka hedhur këtë napë të zezë mbi fytyrën e qiellit dhe këtë mbulesë të bardhë sipër tokës? Ç'janë këta flamurë prej

mjergulle e këta bajrakë prej tymi? Duke valë vitur ata humbasin në pyllin që të shtie frikën.

## 2

Dalëngadalë era u pre fare. Errësira dhe trishtimi po shtoheshin ca nga ca. Dëborë filloi të binte lehtë si fqolla pambuku. Retë u nxinë krejt dhe mbuluan tokën. S'kish mбетur asnjë gjethe, asnjë lule, asnjë fije bari të rëndomtë. Përveç çarçafit të bardhë asgjë tjetër s'të zinte syri. Bota ishte bërë një ngjyrë e vetme. Të dukej se çdo gjë në botë kish-te vdekur, ishte zhdukur pa lënë shënjë. Më s'dëgjoje asnjë zë, asnjë tingull, asnjë mizë. Vetëm një zi e kobshme dhe një heshtje trishtuese kish pllakosur rruzullimin. Jeta ishte bërë e mërzitshme, qielli ishte zemëruar, natyra ishte e pikëlluar, e zyrtë, e brengosur. Kudo një shkretëtirë që të shtie datën. Shtëpitë dukeshin si ca gërmadha të trishtueshme. Nëpër drunjtë s'kishte gjethe të blerta, s'kishte kokrra të bukura, ata ishin ngarkuar me dëborë të ftohtë. Pylli të shtinte frikën, atje ngrije nga të ftohtit, ishte bërë që mos ta shihje me sy.

## 3

Vendin e stolisë dhe të hieshisë së verës e kish zënë shkatërrimi dhe mjerimi që kish sjellë dimri. Hapësira dukej si një shtatore që të kallte frikën. Ah, moj botë e shkretët!

Duke qenë dikur aq e endshme e bukur, e dashur, pjellore, e stolisur, e qeshur, e nxehtë dhe plot me erëra kundërmuese, pse je bërë tashti kaq e llahtarshme, bunacë e mvrejtur, burg, krejt e thatë, rrënojë, e brengosur, akull e ftohtë? Ku i ke lulet e sapoçelura dhe gjetet bleroshe? Ku shkoi gjithë ajo hieshi jotja? Sa i ftohtë është savani me të cilin je mbështjellë ti! Sa të shëmtuara, sa vramuze janë këto re të zeza që të mbulojnë ty!

. . . . .

Edhe gjendja e tanishme e të rinjvet i shëmbëllente kësaj gjendje në të cilën ndodhej tashti bota. Ndjenjat u kishin ndryshuar. Në shpirtërat e tyre kishin lindur dhëmbja, në zemrat e tyre kishte hyrë dëshpërimi dhe brenga. Dashuria e tyre ishte ftohur. Endjet dhe lektisjet e tyre pas dashurisë ishin vyshkur, fytyrat e tyre të lëmuara ishin rrudhur nga të ftohtit. Boria e fundit e vjeshtës kishte mbledhur ushtrinë e dashurisë, kurse era e saj e kishte shpërndarë krejt këtë ushtri. Një dorë e fshehtë u kish zënë zemrat dashnorëvet dhe u kish prerë lidhjet që i bashkonin ata.

Ashtu si mbetën cullakë drunjtë pas rënjes së gjethevet, ashtu kishin mbetur pa gjë edhe zemrat e tyre mbasi kishin humbur dashurinë dhe gazin. Mbarimi i lumturisë së njëhershme i kishte lënë në brengë dhe në shtrëngim të jashtëzakonshëm zemrat e tyre të butëza dhe të mira. Shpirti dhe zemra e nje-

riut s'janë të zonjat prej vetiu që të durojnë gjëra të jashtëzakonshme. Ashtu si i mjeron gjëma e madhe, ashtu i shqetëson edhe lumturia e tepërt.

## 4

Mbasi u patën dashuruar gati sa të adhuronin njeri-tjetrin, këtej e tutje, me zemrën që ishte bërë tashti si kokrrat e pemëve që prishen kur u shkon koha, që kish humbur sillmën e freskinë dhe që kishte mbetur shkret pa zjarrin e dashurisë, asnjëri nuk donte që ata të jetonin bashkë. E ç'dobi ka t'i frysh zjarrin që është shuar e bëri hi?

Mbarimi i çastet të shkëlqyera të ditëve të jetës i lë njeriut mbresa shumë të hidhura; kur njeriu kujton ditët e takimit, shtohen dhëmbjet e ndarjes...

Humbja e lumturisë është e hidhur dhe pikëlluese vetëm sepse njeriu kujton çastet e ëmbla të lumturisë.

## 5

Mbasi pushoi dëbora, dolli që prapa një muri një njeri, i ri me moshë, i cili ish mbështjellë me një mallotë dhe që dukej i brengosur dhe i zyrtë. Ai hodhi një shikim përçark, pastaj duke tundur kokën që s'po mundej të shihte atë që kinse kërkonte, ose që s'po gjente atë që kinse kish parë dikur, filloi të fliste përçart duke ecur rrugës



së mbuluar me dëborë, nën drunjtë që rrëzonin përdhe dëborë.

Por as frika që të shtinin drunjtë e mbuluar me dëborë, as retë e zeza e të llahtarshme, as mjergulla që sulmonte nga çdo anë, as të ftohtit që i kish ngrirë trupin dhe gjymtyrët, as dëshpërimi dhe mërzia që i jepte vetëmia, asnjë nga këto spo mundonin t'i tërhiqnin atij vëmendjen dhe ta bënin të mendohesh.

Duke i pasë sytë të ngulur te dritarja që dukej përkundrejt, ai shkonte e vinte si i mpirë e si pa mend dhe me trishtimin e njeriut që shkon të shkon të shohë natën të vrazët në fushën e betejës.

## 6

Ky njeri ishte djaloshi ynë. Donte të shihte këtë vend që ishte kujtimi i çastëve që kish kaluar bashkë me të dashurën e zemrës, i lumtur, i gëzuar dhe siç ja kish dëshiruar zemra, duke shijuar dashurinë dhe miqësinë e ngrohtë. Por kot! Çdo gjë kish ndryshuar. Ndryshimet rrënjësore kishin zhdukur fare çdo gjë të mëparshme.

Çdo kënd i pamjes që shtrihej përpara, çdo dru, rrugët, kroi të kujtonin ngjarjet e ëndshme të asaj kohe të lumtur ... Ato ditë të bukura, ajo kohë e ëmbël, ato gjëra të ëndshme, ajo lumturi e shkuar i kalonin prapë nëpër mend.

Ah, çdo gjë kish ndryshuar! Kujtimi i asaj begatie që kish kaluar nuk bënte tjetër vetëm se e shtonte më tepër dëshpërimin dhe brengën. Sa herë që i shkreti kujtonte atë kohë, nxirrte psherëtima të thella e të ftohta. Meqë i ranë në kokë të këtilla krajata që po e dërmonin, ai e quante veten shumë fatkeq.

Kur kujtonte lumturinë e vjetër që i pat sjellë zemrës dashuria dhe gëzimin që pat ndjerë nga miqësia e ngrohtë me të dashurën e tij të ëndshme, atij i pëlqente të vdiste më mirë. Ndryshimet që shikonte midis pranverës dhe dimrit dhe ndryshimet që kishin ndodhur në natyrë ai i krahasonte me ndjenjat dhe më gjendjen e tij.

I kullonte gjak zemra kur shikonte ndryshimet e padëshirueshme që ishin bërë në veten e tij, në mendimet, shpirtin, zemrën dhe në mendjen e tij dhe kur mendonte se fati ja mori sërish me të përdhunë e pa ndonjë shkak lumturinë që i kish dhuruar atij.

Ndryshimi i natyrës, gjendja e vendit për qark dhe ngjarjet shqetësuese të dimrit e brengosnin edhe një herë më tepër.

Ashtu si nuk besonte që të ktheheshin edhe një herë ato ditë të uruara që pat kaluar me dashuri dhe me të dashurën e tij, po ashtu kish prerë çdo shpresë se do të shihte edhe një herë dallëndyshet e pranverës. Humbja e shpresës bënin që brenga dhe dhëmbbja t'i dukeshin të përhershme dhe ngjarjet e dimrit si gjëra që s'do të kalonin kurrë.

Shkoi gjer atje ku mbaronte sheshi. Qëndroi një copë herë përpara një dritareje të

hapur përgjysëm dhe u zhyt në detin e mejtimevet. Filloi të sillte ndërmend një nga një, me sa mundej, të shkuarat që kish jetuar me shpirtin dhe me mendjen e tij. Zogjtë e bukur dhe jonet e tyre, lulet dhe era e tyre e dashur, rrezet e diellit, gjethet e blerta, pemët e shijshme, puhizën e lehtë, shetitjet që kish bërë bashkë me miken, hieshinë e vashës së ëndshme, ëmbëlsinë e saj, dashurinë që kish pasur ajo për të, të gjitha këto ai i kujtoi i vrerosur dhe me dhëmbje të madhe në shpirt. Por kur erdhi në vete, e pa se ishte fill i vetëm, i përhumbur, i xhveshur nga çdo gjë ...

Ishte i pikëlluar sa s'kish më. Megjithëkëtë, pa dashur as ai vetë, një dëshirë e fshehtë po e shtynte që dilte për shetitje. Donte sdonte, mori rrugën drejt nga pylli. I vdirë dhe i cfilitur përbrenda dhe me zemër që i rrihte fort, ai rrotulloi gjithandej sytë që të gjennte vendin ku patën kuvenduar e dëfryer së bashku me vashën nazemadhe, që ai pati dashuruar për herën e parë në jetë, në mes lulesh të posaçelura dhe erërash të ëndshme, nën drunjtë e lulëzuar. Por nuk e gjeti dot këtë vend që pat kundërmuar atëhere e që pat qenë stolitur me manushaqe, zymbyla, bathra, zambakë e lule të tjera. Ajo lëndinë e bukur si parajsa ishte vetëm në kujtesën e tij. Tashti të gjitha ishin zhdukur e bërë si mos më keq. Dheu i shkretë kish ngrirë nën dëborën, ashtu si zemra e djaloshit të gjorë nga të ftohtit.

Duke hedhur në mes të këtyre dhëmbjeve një vështrim të llahtarshem rreth e rro-

tull, ai e pa qiellin që ish vetëm një tym i zi dhe botën të heshtur dhe të mbetur shkret.

Duke e parë veten në këtë lëndinë që të shtinte frikën, ai shtangu në vend i habitur dhe i mpirë. Prandaj mbuloi fytyrën me duart e tij dhe zuri të qante. . . . .

## 7

Tek ishte duke qarë dhe i fundosur në mendime, i zuri syri një gjurmë. U përkul dhe e vërejti për një kohë të gjatë këtë gjurmë. I zoti i kësaj gjurme së pari kishte dalë në një kojë, pastaj kishte kaluar përmes një livadhi. Ai kishte ecur herë me të shpejtë dhe i shqetësuar, herë mengadalë dhe duke menduar. Kuptohej se kjo ishte gjurma e këmbës së një vashe të vogël. Dilte gjithashtu se i zoti i gjurmës kishte ecur duke qenë i dëshpëruar, i brengosur, i shqetësuar.

Duke vërejtur me vëmendje këtë gjurmë, ai u skuq nga fytyra, ju lëndua zemra aq shumë dhe e humbi fare. Filloi sërish të binte dëborë. Era shakullore çonte përpjetë dëborën dhe ja hidhte atij në fytyrë, ja përplaste në kraharor.

Kur gjurma humbiste dalngadalë, ai fshinte si i leshtë dëborën nga mallota dhe ndiqte njerinë e panjohur. Duke shpejtuar hapatë, duke ndjekur kështu pas gjurmave këmbë për këmbë njerinë e panjohur, ai pa më në fund një trup të çuditshëm njeriu nën një rrap krejt të zbardhur e të ngarkuar me

dëborë, më të dalë të një suke aty afër.

Ja, ky trup i kishte bërë ato gjurma, ai kish qenë vravashka e djaloshit. Me fytyrën të mbuluar me të dyja duart, ai po qante shumë i pikëlluar. Duke u dridhur, djaloshi niset drejt atij, i afrohet me hapa të lehta, i vë ngadalë dorën në sup dhe ja heq duart nga fytyra. Shohin njeri-tjetrin. Ishte vesha e gojtrë! . . . . .

## 8

Edhe ajo e shkreta qante se ja kish dashur shpirti dhe zemra dhuratën e madhe të dikurshme. Për të larguar brengën dhe për t'i dhënë kështu pak ngushëllim zemrës së rrënuar, ajo kishte shkuar atje ashtu si shkon nëna te varri i fëmisë së saj të vdekur.

Duke u takuar kështu papandehur, u trembën që të dy. Ata qenë ndarë të zemëruar nga njeri-tjetri dhe kjo i pat bërë që të binin në një gjeratore brengje dhe trishtimi. Duke qenë që të dy në këmbë, të përshkuar nga dridhmat dhe me leshrat ngritur përtpjetë, ata po jetonin atë gjendje mjerimi të thellë që pushton atin dhe nënën, të cilët, mbasi janë endur për një kohë të gjatë, secili në një anën për të kërkuar zemrat e tyre që i kanë humbur, takohen sërish, por duarzbrazët.

Duke e dashur dashurinë, por pa qenë të zotët që ta donin njeri-tjetrin këtej e tutje, ata i ktheheshin plot zëmërim dashurisë, që u

dukej si një gjë e vdekur, dhe pyetnin kohë e më kohë se cili nga të dy e kish shpartalluar atë.

Ata ishin këtu si kryeprindërit e njerëzimit, të cilët mbasi qenë përzënë nga bukuritë e qenë dërguar në këtë tokë që t'i binin kokës me grusht, të rozbiteshin dhe të bëheshin si mos më keq. Kur kujtonin të kaluarën, ata dhembkoseshin më shumë, u shtoheshin brenga më tepër. Meqenëse po shiheshin për herë të parë në atë vend të trishtimshëm, ata shikonin njëri-tjetrin si të huaj, të tronditur dhe si të shushatur.

## 9

Ndërkohë djaloshti u hodh e tha: — „Dashuria ashtu si erdhi pa na pyetur ne, ashtu s'na mori leje dhe kur iku. Ajo jetoi në zemrat tona aq sa mund të rrojë një trendafil në mes të gjetheve bleroshe. Dashuria është një dhuratë e madhe, shumë e ëmbël. Është lumturia e njeriut, begatia e njeriut; ajo është shumë e dashur. Por siç është e natyrshme lindja dhe rrojtja, ashtu është e natyrshme edhe vdekja. Asnjë forcë nuk mundet ta ngjallë më atë. Vdiq! Iku! Zemra jonë mbeti shkret. Ajo që na donte zemra u zhduk dhe u bë pluhur. U tretën ato ndiesitë e holla! As besnikëria jote, as fisnikëria jote e ëndshme që vlente të nderohej, as dliresia jote e pafajshme, as shikimi yt depërtues, as ajo sjellje ledhatuese që më bënte të të shikoja si një shtatore të një begatie të vjetër, as bukuria jote joshëse, as

kujtimi dhe mbresat e ëmbla të asaj kohe që dimë ne... as ajo grimëz dashurie që ka mbetur edhe në zemrat tona... asnjëra nga këto nuk mund ta kthejë nga rruga zogun e dashurisë që është në të fluturuar. Në zemrat tona kemi vetëm dhëmbjen që na la ajo.

Ah, pse vallë nuk e kemi në dorë veten tonë? Pse nuk duket dora që na thyn e që na drejton? Plogështi e pafund! Tallje e përjetshme! Mos vallë njeriu ardhka në botë që të vuaj?". Pastaj filloi të bariste si i lënë.

Kur e pa vasha se djaloshi, që kish qenë dashnori i saj i përhumbur po mundohej shumë dhe po i përpëlitej zemra tej masës, ju afrua pranë menjëherë. Djaloshi kish rënë mbi dëborë si të ish një rrëzuar nga era e fortë. Vasha hapi sytë e saj të mëdhenj dhe vështroi me kujdes, duke marrë një pamje të çuditshme. Kur pa se po ato ndryshime dhe po ato ndjenja që po zhuritnin zemrën e saj ishin edhe te dashnori, i erdhni keq për këtë të shkretë. Djaloshi u ngrit dhe duke i hedhur vashës duart në qafë i tha: — „Ah, u vyshkën një nga një boçiat e çelura të bukura të trendafilishtes së dashurisë. Shkuan e vajtën ato ditë të bukura! Të mirat e dashurisë. Shkuan e vajtën ato ditë të bukura! — Të mirat e dashurisë u bënë pluhur. Mbetëm shumë fatkeq. Si mund të durojmë që ky mjerim të na i shkretojë fare zemrat?".

— Vërtet, ndjenjat tona kanë ndryshuar. Është e pamundur të mposhtet natyra. S'ka rrugë tjetër veçse t'i nënshtrohemi ligjit të saj të lartë, — tha asohere vasha dhe filloi të ecte

plot shije e fisnikëri. Nga sytë e të dyve dilte zjarr. Shikonin njeri-tjetrin pa besim. Pastaj djaloshi foli me zë të ulët: „Meqë dashuria po vdiqet, të paktën pse ta përlyejmë me një qëndrim të këthillë të ftohtë shoqërinë tonë, atë shijen e ëmbël të njehershme, atë lumturin tonë të dikurshme? S'është aspak e hijshme që dashuria jonë, e cila ishte dikur aq e vyer dhe e lartë, të kënaqet tashti me një nderim të rëndomtë. Dashuria që pat mbirë si një bisk i njomë në zemrat tona, dashuria që na pat dhuruar ç'na pat dashur zemra që një lumturi e madhe për ne. Por ç'e do se iku! Ilturoi! Sa keq! U zhduk, u bë pluhur!”

Po e dashura nuk i dëgjoi fjalët e tij se kish ikur. Kur pa djaloshi se e dashura u largua, e këputi fare kokën. Duke e kuptuar se do të mundej ta duronte këtë ndarje pikëlluese, ai u lëshua me zemrër të lënduar, shumë i trishtuar dhe i zyrtë, e zuri vashën, i dolli përpara dhe e pushtoi fort. Pastaj duke i rënë ndër këmbë i tha: — „O të duam njeri-tjetrin, o të vdesim që të dy!”. Vasha ja dha të qarit dhe vuri kokën në parzmën e djaloshit. Ata shikuan njeri-tjetrin për të fundit herë me dashuri e me dhëmshuri...

Por qielli e pa të tepërt edhe këtë takim të ngrohtë të çstit të fundit që bënë të rinjtë. Duke shkulumuar nga zilia dhe resa, ai e ndryshoi ngjyrën.



Retë e ndera si perde të zeza sipër tokës u davaritën nga era e vrullshme dhe fillun të ecnin me nxitim në qiell. Drunj të tundeshin sa mënd thyheshin duke rrëzuar përdhe dëborën me të cilën ishin ngarkuar. Nga pylli dëgjohej një zhaurimë e madhe. Borigat e gjata dhe drunj të tjerë dridheshin nga rrënjët gjer në majë duke rrëzuar nga degët gjethet e thata. Nga pylli plasi dhe oshëtiu anembanë ulërime e tmerrshme e ujqërve të uritur. Sorrat lëshuan njëherësh një kithmë shurdhuese. Me një fjalë, heshtja trishtuese që sundonte pak më parë këtu, u kthye në një poterë të llatarshme.

## 11

Po ecnin që të dy duke qenë të mbështjellë djaloshi në mallotën e tij dhe vasha në pallton e saj. Era e fortë bënte që t'u valëviteshin leshrat në ajër. Duart e faqet u kishin ngrirë, këmbët u ishin bërë akull. Sytë u ishin skuqur nga të qartë, buzët u ishin bërë shkumb, kurse fytyra u ishte bërë dyllë e verdhë nga mjerimi, nga brenga, nga të ftohtit. Megjithatë, që të dy dukeshin të ëndshëm sa s'bëhej, të ëmbël sa asnjëherë, shumë të sjellshëm. Shtati dhe të ecurit e tyre shumë të bukur dhe fare të përsosur. Me gjithë dëshpërimin e madh, ata po bënë përpyetje të jashtëzakonshme për ta ngjallur sërish dashurinë. Engjëjt nga njëra anë i tërhiqnin dhe i bashkonin zemrat e tyre, nga tjetra anë i ndanin dhe i largonin.

Por dashuria ishte shuar, s'i kish mbetur më shpirt; zemrat e tyre ishin vdirë, ishin bërë akull. Dashuria që kish ardhur nga bota e fshehtë dhe që kish banuar për ca kohë në zemrat e tyre, u kthye prapë andej nga kish ardhur, e dliurë, larg shijesh trupore Humbja e kësaj së bekuare që pat bashkuar dy zemra të dlira dhe të buta, po bëhej shkak që këto zemra të ndaheshin.

Në të vërtetë, mërmërimi i ëmbël i ujit që rridhte nën akujt i grishte ata që të qëndronin atje, por shiu i shtrëngonte që të iknin. Lladigat e drunjvet ua kishin zënë rrugën, por era i këshillonte që të ktheheshin. U ndanë tashtimë që të dy me një guxim të madh, me një vullnet që rrallë e shikon ndër njerëzit. Sa keq! U ndanë përgjithmonë! Duke vënë çdonjeri dorën në zemrën e vet të plagosur e të pikëlluar, duke psherëtirë e qarë me ngashërim, rendën secili në një anë. Por ndarë e pa ndarë, meqë dhëmbja e ndarjes dhe brenga e mërgimit copëtoi zemrat, u penduan për atë që kishin bërë padashur, prandaj i thirrën njeri-tjetrit që të shiheshin së paku edhe një herë. Bërtitnin me trishtim e shumë të trazuar. Zëri i tyre dëgjohej më mirë se vërshëllima e erës së furishme. Por nga dhëmbja që u la ndarja asnjëri nuk e dëgjon dot tjetrin. Më në fund, asgjë s'po dëgjohej më përveç zhaurimës së erës dhe të drunjvet, përveç uturimës së ujrvet dhe të malevet. Qielli u nxi dhe u bë sterrë Dëbora nisi të binte sërish. Plasi një shtërgatë e madhe, një stuhi e jashtëzakonshme.

Më s'dukej as edhe rrejza më e zbetë që të tregonte se kishte diell. Ungrys... Retë po nxiheshin ca nga ca. S'të zinte syri yll. Qielli u bë sterrë. Era nuk lëvizte fare. Pylli s'pëtinte. Dëbora, që s'binte për herë të parë, sa vinte e po e ngrinte dëborën e vjetër duke e bërë atë si shkëmb. Më s'dgjohej asnjë zë, asnjë jon. Ç'kish e ku kish pllakosur nata e errët, nata e lufgjishme. Bota s'ish gjë tjetër veç dëborë, rë të zeza, heshtje e thellë. Brenda në savanin e tokës shtrihej kufoma e të ftohtit...

*E përktheu nga turqishtja  
Vexhi BUHARAJA*